



iPROCEEDS

Projekti mbi shënjestrimin e të ardhurave nga krimi në Internet në Evropën Juglindore dhe në Turqi

Versioni i datës 5 mars 2018

Raporti i vlerësimit mbi marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale sipas legjislacionit kombëtar në Evropën Juglindore dhe në Turqi

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

4

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Përmbajtja

| | | |
|-----------|--|-----------|
| 1. | Hyrje..... | 3 |
| 2. | Raportet Kombëtare | 4 |
| 2.1. | Shqipëria | 4 |
| 2.2. | Bosnja dhe Hercegovina | 7 |
| 2.3. | "Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë" | 19 |
| 2.4. | Mali i Zi | 23 |
| 2.5. | Serbia | 28 |
| 2.6. | Turqia..... | 33 |
| 2.7. | Kosova* | 39 |
| 3. | Rekomandimet | 43 |
| 4. | Shtojcat | 46 |
| 4.1. | Pyetësi i Zbrazët | 46 |
| 4.2. | Axhenda e punëtorisë rajonale për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike | |

* Ky përcaktim nuk cenon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me KS të OKB-së 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1. Hyrje

Legjislacioni i plotë dhe efektiv që i përmbush kërkesat e të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit është baza për masat e drejtësisë penale kundër krimit kibernetik dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale. Kjo është veçanërisht e vërtetë për kompetencat specifike të ligjit procedural të disponueshëm sipas Konventës së Budapestit, si një kuadër gjithëpërfshirës i ligjit penal vendor për këto kompetenca, gjithashtu lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar mbi krimin kibernetik dhe provat elektronike me Palët e tjera të Konventësprovat. Konceptet e qarta të provave elektronike, kategoritë e të dhënave dhe kufijtë dhe kushtet e sakta për kompetencat procedurale janë thelbësore në këtë aspekt. Prandaj, miratimi i legjislacionit të plotë dhe efektiv mbi krimin kibernetik dhe provat elektronike që i plotëson kërkesat e të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit, konsiderohet një prioritet strategjik.

Këshilli i Evropës ka bërë një vlerësim fillestar të kuadrit rregullator kombëtar mbi marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi, "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Turqi dhe në Kosovë*¹ në bazë të një pyetësoi të plotësuar nga anëtarët e ekipit kombëtar të projektit. Rezultatet e Pyetësoi dhe diskutimet gjatë seminarit rajonal për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike, i cili u mbajt më 2-3 nëntor 2017, në Bukuresht, Rumani, kanë shërbyer si baza e këtij raporti vlerësues, i cili së bashku me rekomandimet e tij përkatëse do t'u mundësojnë autoriteteve të drejtësisë penale që të përmirësojnë më tej kuadrin kombëtar përkatës dhe të zhvillojnë udhëzimet për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale.

Sipas Rezultatit 3 të projektit iPROCEEDS - Njësitë e krimeve kibernetike, hetuesit financiarë dhe njësitë e inteligjencës financiare bashkëpunojnë me njëra tjetrën në nivel kombëtar në kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi kibernetik - projekti do të asistojë autoritetet e drejtësisë penale për të përmirësuar kuadrin rregullator kombëtar përkatës për të siguruar dhe shfrytëzuar provat elektronike në proceset penale përmes një vlerësimi të kuadrit kombëtar, identifikimit të hapësirave boshe si dhe paraqitjes së rekomandimeve korresponduese. Kjo u realizua në tri faza:

- Zhvillimi i një Pyetësoi për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale sipas legjislacionin përkatës kombëtar të shteteve/rajoneve të projektit. Përgjigjet e Pyetësoi u plotësuan nga anëtarët e ekipit kombëtar të projektit, dhe ky proces është koordinuar nga personeli i projektit;
- Një seminar rajonal për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale u mbajt në Bukuresht nga 2 deri 3 Nëntor 2017, për të diskutuar gjetjet paraprake, pas analizës së përgjigjeve të Pyetësoi, dhe për prezantimin e koncepteve të zbatueshme të provave elektronike, kërkesave përkatëse të pranueshmërisë dhe procesit të provave elektronike në kontekstin e hetimeve dhe proceseve penale, në përputhje me dispozitat dhe praktikat e Konventës së Budapestit mbi Krimin kibernetik;
- Ky raport vlerëson legjislacionin dhe rregulloret përkatëse kombëtare mbi marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale, dhe përfshin rekomandimet përkatëse që do t'u lejojnë autoriteteve kombëtare të drejtësisë penale që të përmirësojnë më tej kuadrin kombëtar dhe të zhvillojnë udhëzimet për marrjen dhe përdorimin e provave elektronike në proceset penale. Informacioni në këtë raport është nxjerrë nga legjislacioni kombëtar, përgjigjet e Pyetësoi, rezultatet e seminarit rajonal të mbajtur në Bukuresht dhe kërkime të mëtejshme.

¹ *Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

2. Raportet Kombëtare

2.1. Shqipëria

Përgjigjet e Pyetësorit u dhanë nga një prokuror, një ekspert kompjuterik dhe një hetues i krimit kibernetik nga Policia e Shtetit, si dhe një avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Pas ratifikimit të Konventës së Budapestit, u kryen ndryshime ligjore për të pohuar se provatprovat elektronike janë të pranueshme në çështje penale.² Pranueshmëria në përgjithësi vendoset në bazë të standardeve të caktuara nga Kodi i Procedurës Penale për pranimin e çdo lloji prove. Kjo qasje mund të paraqesë probleme ligjore dhe praktike, siç janë sfidat ndaj besueshmërisë së provave elektronike dhe sigurimi i tyre përmes operacioneve të fshehta ose nga shtete të tjera, si dhe ngadalësia për marrjen e të dhënave nga jashtë Shqipërisë.³

Gjyqtari autorizon kontrollin e kompjuterëve apo rrjeteve, duke specifikuar të drejtën për hyrje, kontroll dhe marrje të të dhënave, si dhe duke ndaluar çdo veprim tjetër që ndikon në integritetin e të dhënave apo sistemit. Kontrolli dhe sekuestrimi duhet të respektojnë këtë rregull me përpikëri. Një gjyqtar, prokuror, ose oficer i policisë gjyqësore mund të autorizojë ekzaminimet kompjuterike, të kompjuterëve, imazhimin e të dhënave dhe marrjet në kohë reale. Hetuesve nuk u kërkohet të sekuestrojnë objekte fizike për të siguruar të dhëna, mirëpo delegatët shqiptarë raportuan se është e vështirë që të zbatohet sekuestrimi i të dhënave pa sekuestrimin e një objekti fizik.⁴ Kur nuk sekuestrohet asnjë objekt fizik, hetuesit shfrytëzojnë marrjet në kohë reale të të dhënave (nëse të dhënat gjenden jashtë vendit, përdoret Asistenca Reciproke Juridike).⁵

Nuk ka udhëzime kombëtare për sekuestrimin e provave elektronike, kështu që hetuesit e Njësisë së Ekspertizës KompjuterikeKompjuterike ndjekin standarde të brendshme. Në prezantimin e saj, në Bukuresht, Shqipëria e identifikoi si problem mungesën e standardeve të shkruara për hyrjen në provatprovat elektronike për veprime hetimore, ashtu si edhe kapacitetin e kufizuar teknik të Ofruesve të Shërbimeve të Internetit, agjencive të zbatimit të ligjit dhe të institutit të ekspertizës.⁶

Hetuesit do të kërkojnë asetet e ruajtura në formë elektronike në rastet e krimit të organizuar ose financiar. Asetet e tilla mund të sekuestrohen në të njëjtë shkallë si të dhënat e tjera elektronike.⁷ Pas lëshimit të urdhrat për kontroll nga gjykata, prokurori mund të drejtojë kontrollin ose mund t'ia delegojë detyrën oficerëve të policisë gjyqësore. Kontrolli dhe sekuestrimi mund të mbeten konfidencialë. Pavarësisht se cila zyrë e zhvillon kontrollin, masat duhet të ndërmerren për të siguruar integritetin e të dhënave.⁸ Ndonëse nuk ka rregulla të qarta në Kodin e Procedurës Penale që mbulojnë zinxhirin e kujdestarisë, standardet e përgjithshme procedurale zbatohen për të garantuar mbrojtjen e provave. Prandaj, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore i deleguar nga prokuroria për të kryer kontrollin duhet të ndërmarrin masa për të ndaluar hyrjen në të dhëna apo për t'i hequr të dhënat nga kompjuterët me të drejta hyrje. Pas sekuestrimit, të dhënat dërgohen

²Përgjigjet e Pyetësorit (pyetjet 1a dhe b); Prezantimi i delegatëve shqiptarë gjatë seminarit rajonal në Bukuresht. Të gjitha referencat ndaj neneve në këtë seksion janë nga Kodi i Procedurës Penale.

³ Përgjigjet e Pyetësorit (pyetjet 2 dhe 4); krahas kësaj, për ruajtur pranueshmërinë potenciale, qeveria duhet të ndërmarrë masa për të parandaluar aksesin në të dhënat elektronike në pajtim me urdhrat e gjykatës 1c; Prezantimi i delegatëve shqiptarë gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

⁴Përgjigjet e pyetësorit (Pyetjet 5-9, 34); Neni 208a, Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike (Prezantimi i delegatëve shqiptarë gjatë seminarit në Bukuresht).

⁵Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 10, 12).

⁶Përgjigjet e pyetësorit (pyetja 13); Prezantimi i delegatëve shqiptarë gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

⁷Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 37, 39).

⁸Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 15, 19).

në Njësinë e Ekspertimit Kompjuterik, e cila e bën imazhimin dhe ekzaminimin dhe jep një raport. Një ekspert mund të ketë deri në 60 ditë për një ekzaminim të ndërlikuar. Kjo periudhë mund të shtyhet me nga 30 ditë, por maksimumi i lejuar është gjashtë muaj.⁹ Nëse është e nevojshme mund të përdoren ekspertët e jashtëm.¹⁰ Më pas, provat ruhen nga prokuroria dhe mund të mbahen pa ndonjë afat të caktuar.¹¹

I pandehuri ose një përfaqësues i tij mund të jenë të pranishëm gjatë kontrollit, imazhimit dhe ekzaminimit ligjor. Prania e mbrojtjes gjatë dy proceseve të fundit mund të paraqesë vështirësi të dukshme praktike.¹² Mbrojtja ka të drejtë që të marrë një kopje elektronike të provave dhe mbi këtë kopje mund të kryhet çfarëdo lloj ekzaminimi ligjor.¹³ Janë paraqitur kundërshtime të ndryshme të mbrojtjes ndaj provave elektronike, si defektet në zinxhirin e kujdestarisë ose akuzat se i pandehuri ishte viktimë e ndërhyrësve (që supozohet se kanë vendosur të dhënat në kompjuterin e tij/saj) ose nuk ishte pronar apo nuk i kishte përdorur të dhënat.¹⁴

Nëse të dhënat elektronike ofrohen si provë në gjykim dhe ato kundërshtohen nga mbrojtja, prokurori duhet që të provojë integritetin e të dhënave duke i ftuar oficerët e policisë gjyqësore dhe ekspertët për të dëshmuar për çdo procedurë të zbatuar që nga momenti i sekuestrimit të të dhënave deri në prezantimin e tyre në gjykatë.¹⁵ Neni 152 i KPP parasheh përcaktimin e saktësisë dhe autenticitetit të provave.¹⁶ Ekspertit raportues mund ti kërkohet të dëshmojë, nga gjyqtari, prokurori ose mbrojtja, veçanërisht për të shpjeguar raportin e ekspertimit ligjor dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me rastin. Eksperti mund të konsiderohet penalisht përgjegjës për sjellje të pahijshme.¹⁷

Pajisjet, të dhënat dhe asetet që ruhen në formë elektronike i kthehen pronarit (duke përfshirë edhe të pandehurin) pas mbylljes së çështjes, nëse nuk ka nevojë të mëtejshme për to dhe nëse ato nuk kanë qenë instrumente të krimit ose nuk janë të paligjshme në vetvete.¹⁸

Është e mundur që të sigurohen të dhëna nga palët e treta, KPP përmban baza specifike ligjore për këtë (Nenet 191/a, 208/a, 299/a dhe 299/b). Në veçanti, Neni 191/a parasheh proceset penale në lidhje me krimet në fushën e teknologjisë informative, duke pohuar se "Gjykata, në rastin e procedimeve për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit, me kërkesë të prokurorit ose të të dëmtuarit akuzues, urdhëron mbajtësin ose kontrolluesin të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në një sistem kompjuterik apo në një mjet tjetër memorizimi."

Nëse është e nevojshme, hetuesit mund të t'i sekuestrojnë të dhënat edhe me mbështetjen e një eksperti të caktuar nga gjykata. Palët e treta mund të bashkëpunojnë vullnetarisht me prokurorinë dhe t'i dorëzojnë të dhënat në bazë të Neneve 198 dhe 201 të KPP. Çështja mund të mbetet konfidenciale. Në këto raste zbatohen rregullat standarde të kompjuterikemoskontaminimit kompjuterik.¹⁹ Provat mund të sigurohen nga vendet e tjera përmes Asistencës Reciproke Juridike.²⁰ Provat nga jashtë vendit janë të pranueshme vetëm kur sigurohen përmes Asistencës Reciproke Juridike, dhe raportohet se ka pasur raste kur provat e siguruara jashtë vendit nuk janë pranuar për shkak se ishin siguruar jo zyrtarisht.²¹

⁹Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 14, 18 dhe 17).

¹⁰ Diskutimet gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

¹¹Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 1c dhe 14).

¹²Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 23-25).

¹³Përgjigjet e pyetësorit (pyetja 22).

¹⁴Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 22, 26 dhe 29).

¹⁵Përgjigjet e pyetësorit (pyetja 21).

¹⁶Përgjigjet e pyetësorit (pyetja 18).

¹⁷Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 20, 35 dhe 36).

¹⁸Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 27, 28 dhe 38).

¹⁹Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 40-42).

²⁰Përgjigjet e pyetësorit (pyetja 16).

²¹Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 43, 44).

Shqipëria ka përvojë me përdorimin e provave elektronike në gjykata, por atje ka probleme me përdorimin e tyre. Këtu përfshihen pajisjet dhe programet e vjetruara (sidoqoftë, ekspertët mund të sjellin pajisjet dhe programet e tyre). Vetëm disa gjyqtarë kanë njohuri sipërfaqësore për analizën e ekspertizës elektronike; për më tepër, parashtruesit e provave mund të hasin afate tepër të shkurtra, mungesë të të kuptuarit të raporteve të ekspertizës, ose kërkesa për t'i printuar të dhënat, duke përfshirë printimin e të gjitha të dhënave kur vetëm një pjesë e vogël e tyre janë të nevojshme.²² Zëvendësuese, sic janë raportet e ekzaminimeve të ekspertëve dhe ekzaminimet e vendeve dhe sendeve, mund të përdoren në vend të provave kompjuterikeelektronike.²³

Gjatë diskutimeve në puntorinë rajonale në Bukuresht, dhe në përgjigjen e Pyetjes 45, Shqipëria ka dhënë disa rekomandime:

- Përkufizimi i provës elektronike në KPP do të ishte i mirëseardhur.
- Duhet të hartohen rregulloret të cilat i përcaktojnë procedurat standarde të operimit (PSO-të) për trajtimin e provave elektronike. Rregulloret ndryshohen më lehtë sesa KPP-ja.
- Qartësimet në ndonjë formë apo rregullore do t'i nxisin gjykatat dhe prokurorët që të përgatisin urdhëra më të qartë dhe më specifik për kontrollet (në rastin e gjyqtarëve) dhe ekzaminimet (prokurorët).
- Nevojiten ndryshime dhe përkufizime ligjore për të mbuluar konfiskimin, ruajtjen, trajtimin dhe menaxhimin e të dhënave.
- Kërkohen rregullore shtesë për të mbuluar çështje të tilla si operacionet e fshehta ose rastet e vjedhjes së identitetit.
- Kërkohen ndryshime ligjore për të mbledhur të dhënat e përdoruesve nga ISP-të në përputhje me urdhrin e një prokurori, në vend të një urdhri të gjykatës.
- Kërkohen ndryshime të tjera ligjore për të mbuluar operacionet e fshehta të krimeve kibernetike, bashkëpunimin ndërkombëtar mbi krimin kibernetik, dhe proceset penale në lidhje me asetet elektronike (marrjen, administrimin dhe konfiskimin e tyre). [nga prokurori dhe hetuesit]
- Praktikrat për trajtimin e të dhënave duhet të përmirësohen dhe të zbatohen me përpikëri - duke përfshirë sekuestrimin, në mënyrë që asnjë veprim në atë fazë të mos i ndryshojë të dhënat. Nëse nevojitet një veprim, ai duhet të bëhet vetëm nga një ekspert i trajnuar, me dokumentimin e përpiktë të çdo veprimi.
- Kërkohen ndryshime statusore për të adresuar marrjen e të dhënave nga shërbimi "cloud", sepse shumica e të dhënave ruhen në "cloud" dhe serverët e tyre janë pothuajse gjithmonë jashtë territorit shqiptar. [nga hetuesit e ekspertizës kompjuterikekompjuterike]
- Është e nevojshme që të vendoset baza ligjore për verifikimin e provave. Kjo duhet të bëhet drejtpërdrejt në një sistem kompjuterik nga mbrojtja pas procesit të ekzaminimit shtetëror. [nga avokati mbrojtës]
- Kërkohen përmirësime të vazhdueshme të njohurive dhe të kuptuarit të teknologjisë nga ana e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve. Trajnimet për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë duhet të jenë të vazhdueshme, jo vjetore.

²²Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 31-33).

²³Prezantimi i delegatëve shqiptarë gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

2.2. Bosnja dhe Hercegovina

Përgjigjet e Pyetësorit u dhanë nga prokurorët, hetuesit e krimeve kibernetike, hetuesit e ekspertizës ligjore kompjuterike, hetuesit financiar dhe avokatët mbrojtës nga nivelet shtetërore, të entiteteve dhe qarqeve.²⁴

Provat elektronike nuk janë përkufizuar në veçanti në legjislacion. Referenca për provat elektronike mund të gjendet në udhëzimin operacional, përkatësisht Nenin 19 të Rregullores për mënyrën dhe kushtet e ruajtjes së provave materiale, i cili përkufizon etiketimin dhe ruajtjen e provave që përmbajnë dëshmi kompjuterike.²⁵ Manuali "Marrja e Provave Ligjore në Procedimet Penale" përkufizon provatprovat substanciale dhe indirekte, provatprovat personale dhe aktuale, provatprovat e prokurorisë dhe provatprovat e mbrojtjes, provatprovat e ligjshme dhe provatprovat e paligjshme.²⁶

Sipas ligjeve të procedurës penale, veprimet që synojnë marrjen e provave janë²⁷:

- Kontrolli i rezidencave, godinave të tjera dhe pronës personale
- Kontrolli i personave
- Sekuestrimi i postës, telegrameve dhe dërgesave të tjera
- Urdhri i lëshuar për një bankë ose ndonjë person tjetër juridik
- Urdhri për operatorin e telekomunikimit
- Sekuestrimi i pronës
- Marrja në pyetje e të dyshuarit
- Ekzaminimi i dëshmitarëve
- Zhvillimi i hetimit në një skenë krimi
- Rindërtimi i ngjarjeve
- Vlerësimi i ekspertit
- Veprimet speciale hetimore.

Një numër i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës (KPP i BH) u referohen llojeve të provave, përkatësisht:

- Neni 20(n) i KPP të BH i përkufizon termat "shkrimet" dhe "regjistrimet" si referenca të "përmbajtjes së letrave, fjalëve ose numrave, ose barasvlerave të tyre të gjeneruara nga shkrimi me dorë, me makinë, printimi, fotokopjimi, fotografimi, regjistrimi me impuls magnetik ose regjistrimi elektronik, ose format e tjera të përpilimit të të dhënave".
- Neni 20(p) i KPP të BH e përkufizon termin "origjinal" si referencë të "një shkrimi, regjistrimi ose një ekuivalent i ngjashëm që e ka për synim efektin e njëjtë nga një person që e shkruan, regjistron apo publikon atë. "Origjinali" i një fotografie përfshinë negativin ose çdo kopje nga

²⁴ Pyetësori u plotësua: në **Nivelin shtetëror** – nga Zyra e Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës; Agjencia Shtetërore për Hetim dhe Mbrojtje e Bosnjës dhe Hercegovinës (SIPA); Agjencia për Ekspertizë Ligjore e Bosnjës dhe Hercegovinës; në **Nivel të Entitetit (Federatës)** – nga Zyra e Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës; Ministria Federale e Punëve të Brendshme e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës; në **Nivel të Entitetit (Republika Srpska)**- nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republika Srpska; **Qarku Brqko** – nga Zyra e Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës; Policia e Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Zyra për Ndhimë Ligjore e Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës.

²⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Agjencisë Shtetërore për Hetim dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 1).

²⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos (pyetja 1).

²⁷ Kapitulli VIII i Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës (nene identike ekzistojnë në Kodin e Procedurës Penale të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Kodin e Procedurës Penale të Republika Srpska dhe Kodin e Procedurës Penale të Qarkut të Bërçkos).

ai. Nëse të dhënat janë ruajtur në një kompjuter apo pajisje të ngjashme automatike për përpunimin e të dhënave, çdo shtypje ose produkt i lexueshëm me të shikuar konsiderohet si "original".

- Neni 65(6) i KPP të BH, në lidhje me urdhrat për sekuestrimin e objekteve thotë se "dispozitat e paragrafit 5 të këtij Neni do të zbatohen për të dhënat e ruajtura në pajisjet për përpunimin automatik ose elektronik të të dhënave. Gjatë marrjesmarrjes të të dhënave të tilla, vëmendje e veçantë do të tregohet në lidhje me rregulloret mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të caktuara."
- Neni 51(2) i KPP të BH, në lidhje me kontrollin e rezidencave, objekteve të tjera dhe pronës personale, thotë se "kontrollimi i pronës personale në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni do të përfshijë kontrollin e një kompjuteri ose pajisjeve të ngjashme për përpunimin automatik të të dhënave që ndërlidhen me të. Me kërkesë të gjykatës, personi që i përdor pajisjet e tilla, është i detyruar që të lejojë aksesin në to, që të dorëzojë disqet dhe shiritat magnetik ose format e tjera të të dhënave të ruajtura, si dhe që të ofrojë informatat e nevojshme në lidhje me përdorimin e pajisjeve. Një person, i cili refuzon që të bëjë këtë, ndonëse për këtë nuk jepen arsye në Nenin 84 të këtij Kodi, mund të dënohet sipas dispozitave të Nenit 65, paragrafi 5 i këtij Kodi."

ProvatProvat elektronike janë të pranueshme në gjykatat e Bosnjës dhe Hercegovinës përmes interpretimit të provave të tilla në kontekst të kontrollimit të objekteve të lëvizshme, dhe për sa kohë që provatprovat janë mbledhur në mënyrë të ligjshme.

Një gjykatë e autorizon kontrollin e kompjuterëve dhe rrjeteve. Nenet vijuese të Kodit të Procedurës Penale janë cituar:

- Neni 53(2) i KPP të BH thekson se një mandat mund të lëshohet nga gjykata sipas kërkesës së prokurorit ose pas kërkesës nga zyrtarët e autorizuar të cilët janë miratuar nga prokurori.
- Neni 65 i Kodit të Procedurës Penale të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (KPP i FBH) adreson kontrollin e rezidencave dhe objekteve të tjera dhe pronës personale:
 - Neni 65(1): Kontrollimi i rezidencës dhe objekteve të tjera të personit të dyshuar, të pandehurit apo personave të tjerë, si dhe pronës së tij personale jashtë rezidencës mund të zhvillohet vetëm pasi që të ketë bazë të mjaftueshme për dyshimin se kryesi, bashkëfaktori, gjurmët e një akti kriminal ose objekte relevante për proceset penale mund të gjenden atje.
 - Neni 65(2): Kontrollimi i pronës personale sipas Paragrafit (1) të këtij Neni do të përfshijë kontrollin e sistemeve kompjuterike, pajisjeve për përpunimin e automatizuar dhe elektronik të të dhënave dhe pajisjeve të telefonave celularë. Personat që i përdorin pajisjet e tilla, janë të detyruar që të lejojë aksesin në to, që të dorëzojnë disqet dhe shiritat magnetik ose format e tjera të të dhënave të ruajtura, si dhe që të ofrojnë informatat e nevojshme në lidhje me përdorimin e pajisjeve. Personi që refuzon ta bëjë këtë, mund të dënohet sipas dispozitave të Nenit 79, paragrafit (5) të këtij kodi.
 - Kontrollimi i kompjuterëve dhe pajisjeve të ngjashme të përkrahura në Paragrafin (2) të këtij Neni mund të zhvillohet me asistencën e një profesionisti kompetent.

Një gjykatë ose prokuror e autorizon ekzaminimin e ekspertizës ligjore të provës elektronike. Neni 96(1) i KPP të BH thotë se vlerësimi i ekspertit do të kërkohet me shkrim nga prokurori ose gjykata. Kërkesa do të tregojë faktet në lidhje me të cilat është kryer vlerësimi.

Një prokuror e autorizon imazhimin e të dhënave me urdhër të gjykatës dhe gjithashtu e urdhëron marrjen e drejtpërdrejt të të dhënave në pajtim me një urdhër të gjykatës (Neni 35(2)(f) të KPP të BH).

KPP i BH e lejon sekuestrimin e të dhënave pa e sekuestruar objektin fizik (kompjuterin/diskun). Në çështjet penale, sekuestrimi i përkohshëm i objekteve kryhet për përdorim në procedurat e mëtejme penale. Detajet e një rasti të caktuar, situata në terren dhe lloji i krimit do të përcaktojnë nëse objektet fizike do të sekuestrohen ose nëse të dhënat sekuestrohen. Në përgjigjet e pyetësorit është raportuar se në përgjithësi, serverët e kompanive nuk sekuestrohen, sepse hetuesit nuk duan që të pengojnë biznesin në vazhdim të një kompanie, dhe në rastet e tilla sekuestrohen të dhënat. Kompjuterët personal dhe pajisjet e tjera memorizuese zakonisht merren për ekzaminim e ekspertizës ligjore të mëvonshme. Një tjetër përgjigje e pyetësorit tregon se sekuestrimi i objekteve fizike kërkohet për të ruajtur provatprovat elektronike në formën e tyre origjinale. Përrashtim bëhet kur sekuestrimi i objekteve fizike shkakton më shumë dëme sesa dëmet e shkaktuara nga një krim²⁸.

Përgjigjet e pyetësorit po ashtu ofrojnë disa shembuj të bazave ligjore që janë përdorur në rastet praktike ose hapat e tjerë praktikë që përfshijnë sekuestrimin e të dhënave kur nuk është sekuestruar asnjë objekt fizik, dhe/ose për imazhimin e të dhënave në vend, si në vijim²⁹:

- Kontrollimi i pronës personale sipas Nenit 51(1) të këtij KPP të BH do të përfshijë kontrollin e sistemeve kompjuterike, pajisjeve për përpunimin e automatizuar dhe elektronik të të dhënave dhe pajisjeve të telefonave celularë. Personat që i përdorin pajisjet e tilla, janë të obliguar që të lejojnë aksesin në to, që të dorëzojnë disqet dhe shiritat magnetik ose format e tjera të të dhënave të ruajtura, si dhe që të ofrojnë informatat e nevojshme në lidhje me përdorimin e pajisjeve. Personi që refuzon ta bëjë këtë, mund të dënohet sipas dispozitave të Nenit 65(5) të KPP të BH.
- Kushdo që zotëron objekte të tilla duhet t'i dorëzojë ato me kërkesë të gjyqtarit të procedurës paraprake. Personi i cili refuzon që t'i dorëzojë këta artikuj mund të gjobitet deri në vlerën prej 50,000KM dhe mund të burgoset nëse këmbëngul në refuzimin e tij. Burgosja do të zgjasë deri sa të mos dorëzohet artikulli ose deri në përfundimin e proceseve penale, por jo më shumë se 90 ditë. Zyrtari përgjegjës në një organ shtetëror ose entitet ligjor do të trajtohet në të njëjtën mënyrë (Neni 65(6) i KPP të BH).
- Dispozitat në paragrafin paraprak do të vlejnjë edhe për të dhënat e ruajtura në pajisjet për të dhëna të automatizuara ose elektronike. Gjatë marrjesmarrjes të të dhënave të tilla, vëmendje e veçantë do të tregohet në lidhje me rregulloret mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të caktuara (Neni 65(7) i KPP të BH).
- Në rast të provave nga interneti, sipas Neneve 92 dhe 94 të KPP të BH, oficerët policorë, teknikët dhe ekspertët, nëse është e nevojshme i sekuestrojnë të dhënat e regjistruara në mjete memorizuese. Teknikët krijojnë foto dokumentim, i etiketojnë provatprovat kompjuterike dhe i paketojnë si dëshmi, si dhe krijojnë një raport për hetimin penal për t'ia dorëzuar gjykatës së bashku me provatprovat.
- Kopjet e krijuara të hard disqeve, sistemeve RAID dhe hard disqeve virtuale.
- Duke përdorur programe të ndryshme si FAW (Forensic Acquisition of Websites - Marrja për ekspertizë e faqeve të internetit), HTTrack website copier (HTTrack kopjuesi i faqeve), PrintScreen ose programe të tjera për kapjen e pamjeve video ose fotografike të desktopit.

Janë ofruar disa shembuj të udhëzimeve për sekuestrimin e provave elektronike:

- Agjencitë policore i kanë udhëzimet për sekuestrimin dhe ruajtjen e provave elektronike³⁰.

²⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjë dhe Hercegovinës, Zyrrave për Ndhimë Ligjore e Bosnjës dhe Hercegovinës të Qarkut të Bërçkos të Bosnjë dhe Hercegovinës (Përgjigjet e pyetjes 9).

²⁹ Përgjigjet e pyetësorit nga Zyra e Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Agjencia Shtetërore për Hetime dhe Mbrojtje e Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencia për Ekspertizë Ligjore e Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 10).

³⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit Federal të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 13).

- Manuali për kontrollin e sistemeve kompjuterike, pajisjeve për ruajtjen e të dhënave kompjuterike dhe elektronike dhe telefonat celularë³¹.
- Udhëzimet për kontrollin e sistemeve kompjuterike, kompjuterëve dhe pajisjeve për ruajtjen e të dhënave elektronike dhe telefonave celularë³².
- Modeli edukativ "Krimi kibernetik dhe pastrimi i parave dhe hetimet financiare"³³.

Pas sekuestrimit të provave elektronike, KPP i BH përkshkruan si duhet të ruhen provatprovat, si në vijim³⁴:

- Në rastin e sekuestrimit të objekteve në përputhje me mandatin e kontrollimit, zyrtari i autorizuar duhet të hartojë dhe nënshkruajë fletë pranimin ku tregohen objektet e sekuestruara dhe emri i gjykatës që e ka lëshuar mandatin (Neni 63(1) i KPP të BH).
- Objektet dhe dokumentet e sekuestruara do të depozitohen në gjykatë, ose gjykata do të vendos për ruajtjen e tyre të sigurt (Neni 70 i KPP të BH).
- Hapja dhe inspektimi i objekteve dhe dokumenteve të sekuestruara do të bëhet nga prokurori. Prokurori është i detyruar që të njoftojë personin ose ndërmarrjen afariste, të cilëve u janë sekuestruar objektet, gjyqtarin e procedurës paraprake dhe avokatin mbrojtës rreth hapjes së objekteve dhe dokumenteve të sekuestruara. Në rastin e hapjes dhe inspektimit të objekteve apo dokumenteve të sekuestruara, do të tregohet kujdes që asnjë person i paautorizuar të mos ketë akses në përmbajtjen e tyre (Neni 71 i KPP të BH).
- Objektet që janë sekuestruar gjatë proceseve penale do t'i kthehen pronarit ose zotëruesit sapo që të jetë e qartë gjatë procedurave se mbajtja e tyre është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe se nuk ka arsye për sekuestrimin e tyre siç është parashikuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (Neni 74 i KPP të BH).
- Nuk ka kufi kohor për mbajtjen e provave, për sa kohë që provatprovat janë të nevojshme për hetimin penal.

Kërkesat për konfidencialitetin e provave të sekuestruara është adresuar edhe në Kodin e Procedurës Penale³⁵:

- Gjatë marrjesmarrjes të të dhënave nga sistemet kompjuterike, pajisjet për përpunimin automatik dhe elektronik të të dhënave dhe telefonave celularë, vëmendje e veçantë do të tregohet në lidhje me rregulloret mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të caktuara (Neni 65(6) i KPP të BH).
- Gjatë një hetimi, avokati mbrojtës e ka të drejtën që të inspektojë skedarët dhe artikujt e siguruar të cilët janë në favor të të dyshuarit. Kjo e drejtë mund t'i mohohet avokatit mbrojtës, nëse dhënia e skedarëve dhe artikujve në fjalë do të rrezikonte qëllimin e hetimit (Neni 47(1) i KPP të BH).
- Pas parashtrimit të aktakuzës, i dyshuari ose avokati mbrojtës kanë të drejtën që t'i inspektojnë të gjithë skedarët dhe provatprovat (Neni 47(1) i KPP të BH).

³¹ Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 13).

³² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrove për Ndhimë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 13).

³³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrove për Ndhimë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 13).

³⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë Shtetërore për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republika Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 14).

³⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 15).

Kërkesat e konfidencialitetit shtesë do të jenë të zbatueshme në rastet e veprimeve speciale hetuese si survejimi dhe regjistrimi teknik i telekomunikimeve, aksesit në sistemet kompjuterike dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, survejimit dhe regjistrimin teknik të individëve, mjetet e transportit dhe objektet e ndërlidhur me to, përdorimit të hetuesve të maskuar dhe informuesve, blerjes së simuluar dhe të kontrolluar të artikujve të caktuar dhe ryshfetit të simuluar, transportimit dhe dorëzimit nën vëzhgim të objekteve të një vepre kriminale³⁶.

Ligji mbi Mbrojtjen e Informatave të Klasifikuara gjithashtu i përkufizon kushtet sipas të cilave vendoset konfidencialiteti i të dhënave, si dhe kufizimet në lidhje me trajtimin e informacioneve të fshehta³⁷.

Sipas dispozitave të cilat e rregullojnë asistencën ligjore ndërkombëtare, është e mundur që t'i kërkohet asistencë një shteti tjetër, organizate ndërkombëtare ose pale private për ekzaminimin e ekspertizës ligjore kompjuterike³⁸. Asistenca e ekspertëve mund të kërkohet me urdhër të gjykatës apo prokurorit, dhe Neni 51(3) i KPP të BH thekson se "Një kontrollim i kompjuterëve dhe pajisjeve të ngjashme të cilat janë përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni mund të ndërmerren me asistencën e një eksperti"³⁹.

Nuk ka kufij kohorë për ekzaminimin e specifikuar në legjislacion për ekzaminimin e provave elektronike përveç kur ka një kërkesë të përgjithshme (në pajtim me Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) që proceset penale duhet të përmbyllen brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në disa raste, afatet për dorëzimin e rezultateve të ekzaminimeve janë përmendur në urdhrin e gjykatës për ekzaminim⁴⁰.

Prokuroria duhet të vazhdojë të mbikëqyrë procesin hetues për të siguruar ligjshmërinë dhe për të kërkuar regjistrat dhe dëftesat për çdo akses në provatprovat elektronike⁴¹, si dhe për të përcaktuar se kontrollimi dhe ekzaminimi elektronik janë zhvilluar si duhet⁴². Nenet vijuese të Kodit të Procedurës Penale janë cituar⁴³:

- Objektet dhe dokumentet e sekuestruara do të depozitohen në gjykatë, ose gjykata do të vendosë për ruajtjen e tyre të sigurt (Neni 70 i KPP të BH).
- Hapja dhe inspektimi i objekteve dhe dokumenteve të sekuestruara do të bëhet nga prokurori. Prokurori është i detyruar që të njoftojë personin ose ndërmarrjen afariste, të cilëve u janë sekuestruar objektet, gjyqtarin e procedurës paraprake dhe avokatin mbrojtës rreth hapjes së objekteve dhe dokumenteve të sekuestruara. Në rastin e hapjes dhe inspektimit të objekteve

³⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 15).

³⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrave për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 15).

³⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë Federale e Punëve të Brendshme e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 16).

³⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Zyrave për Ndihmë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 16).

⁴⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Zyrave për Ndihmë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 17).

⁴¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 18).

⁴² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetjet 19 dhe 20).

⁴³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 18).

apo dokumenteve të sekuestruara, do të tregohet kujdes që asnjë person i paautorizuar të mos ketë akses në përmbajtjen e tyre (Neni 71 i KPP të BH).

- Gjatë zhvillimit të kontrollimit të sistemeve kompjuterike, pajisjeve për përpunimin automatik dhe elektronik të të dhënave dhe pajisjeve telefonike, personat që i përdorin pajisjet e tilla, janë të detyruar që të lejojnë aksesin në to, që të dorëzojnë mediat me të dhënat e ruajtura, si dhe që të ofrojnë informatat e nevojshme në lidhje me përdorimin e pajisjeve. Kontrollimi i kompjuterëve dhe pajisjeve të ngjashme, mund të zhvillohet me asistencën e një profesionisti kompetent. (Neni 51(2) dhe (3) të KPP të BH).
- Organi që e urdhëron vlerësimin e ekspertizës do të menaxhojë atë vlerësim të ekspertizës. Përpara se të fillojë prezantimi i provës së ekspertit, eksperti do të ftohet që të studiojë me kujdes subjektin e provës së tij, dhe do të paraqesë saktësisht gjithçka që ai di dhe gjen, dhe ai do të ftohet që të paraqesë mendimin e tij të paanshëm dhe në pajtim me rregullat e shkencës apo artit të tij. Ai, posaçërisht do të paralajmërohet se dhënia e provës së rreme është një vepër penale (Neni 99(1) i KPP të BH).

Për të siguruar pranueshmërinë e provës elektronike, prokuroria duhet të identifikojë dëshminë në aktakuzë dhe të sigurojë gjykatën se dëshmia nuk është siguruar përmes shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara me Kushtetutën e Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe as në kundërshtim me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Bosnja dhe Hercegovina, e as përmes shkeljeve thelbësore të Kodit të Procedurës Penale (Neni 10(2) i KPP të BH)⁴⁴. Krahas kësaj, prokurorisë mund t'i kërkohet që të vërtetojë se të dhënat nuk janë ndryshuar që nga sekuestrimi i tyre, nëse mbrojtja parashtron një vërejtje të tillë⁴⁵.

Mbrojtja mund të ekzaminojë një kopje të ekspertizës të provës elektronike⁴⁶. Në pajtim me Kodin e Procedurës Penale:

- Gjatë një hetimi, avokati mbrojtës e ka të drejtën që të inspektojë skedarët dhe artikujt e siguruar të cilët janë në favor të të dyshuarit. Kjo e drejtë mund t'i mohohet avokatit mbrojtës, nëse dhënia e skedarëve dhe artikujve në fjalë do të rrezikonte qëllimin e hetimit (Neni 47(1) i KPP të BH).
- Pas parashtrimit të aktakuzës, i dyshuari ose avokati mbrojtës e kanë të drejtën që t'i inspektojnë të gjithë skedarët dhe provat (Neni 47(3) i KPP të BH).
- Pas konfirmimit të disa ose të gjitha pikave të aktakuzës, gjyqtari i procedurës paraprake do t'ia prezantojë të akuzuarit dhe avokatit të tij mbrojtës aktakuzën, duke përfshirë edhe provat që i mbështesin akuzat e aktakuzës (Neni 228(4) i KPP të BH në lidhje me Nenin 227(1)(g) të KPP të BH).

I pandehuri apo një përfaqësues mund të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit elektronik⁴⁷ si dhe gjatë imazhimit të të dhënave⁴⁸, por jo gjatë analizës së ekspertizës ligjore (ndonëse raporti i

⁴⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 21).

⁴⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetjet 21).

⁴⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 22).

⁴⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 23).

ekspertizës ligjore do t'i dorëzohet të pandehurit dhe atij i lejohet që të angazhojë një ekspert për të kryer analizën e vet)⁴⁹.

Objektet që janë sekuestruar gjatë proceseve penale do t'i kthehen pronarit ose zotëruesit sapo që të jetë e qartë gjatë procedurave se mbajtja e tyre është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe se nuk ka arsye për sekuestrimin e tyre siç është parashikuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (Neni 74 i KPP të BH)⁵⁰. Një përjashtim për këtë është parashikuar në Nenin 391(1) të KPP të BH ku thuhet se artikujt që duhet të sekuestrohen sipas Kodit të Procedurës Penale, do të sekuestrohen edhe kur procesi penal nuk është plotësuar me një vendim që e shpall të akuzuarin fajtor, nëse kjo kërkohet në interes të sigurisë dhe moralit të përgjithshëm. Një aktvendim i veçantë duhet të lëshohet për këtë⁵¹. Nëse pronari shpallet fajtor, pajisjet mbahen përgjithmonë⁵².

Kundërshtime mund të bëhen kundër provave elektronike të prokurorisë mbi këto baza⁵³:

- Relevanca
- Ligjshmëria e konfiskimit
- Ligjshmëria e kontrollimit
- Origjinaliteti
- Trajtimi i papërshtatshëm i të dhënave të konfiskuara
- Shtimi i të dhënave ose të ngjashme.

Në pyetësor u raportua se shumica e gjykatave i kanë pajisjet për prezantimin e provave në formë elektronike dhe ato kanë përvojë me analizën elektronike së ekspertizës⁵⁴. Janë theksuar disa fusha me sfida për prezantimin e provave elektronike⁵⁵:

- Gjykatat mund të urdhërojnë shtypjen e provave elektronike dhe që ato të dorëzohen në letër.
- Gjykatat nuk i kanë pajisjet përkatëse për të prezantuar të dhënat elektronike.
- Njohuri të pamjaftueshme në këtë fushë nga gjyqtarët dhe prokurorët.

⁴⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 24).

⁴⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 25).

⁵⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 27).

⁵¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 28).

⁵² Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska (pyetja 28).

⁵³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 29).

⁵⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetjet 32 dhe 33).

⁵⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetjet 31 dhe 33(a)).

- Sigurimi i dhe trajtimi i paligjshëm/ligjshëm i të dhënave elektronike.
- Disa gjykata nuk i njohin oficerët e certifikuar policorë si dëshmitarë të ekspertizës ligjore kibernetike dhe elektronike.
- Problemet me afatet në urdhra dhe urdhra të paqartë.
- Nuk ka ekspertë të mjaftueshëm për analizën e ekspertizës ligjore.

Nuk është një kërkesë juridike që provat elektronike të prezantohen nga dëshmitarët ekspertë, ndonëse në shumicën e çështjeve provat elektronike në praktikë prezantohen nga një ekspert⁵⁶. Dëshmitarët ekspertë mund të ftohen që të prezantojnë apo vërtetojnë provat elektronike, edhe nëse nuk është kërkesë juridike, në rastet kur kërkohen shpjegime shtesë nga gjykata, prokuroria apo mbrojtja, apo në rastet kur mbrojtja e ngre ndonjë kundërshtim⁵⁷.

Në rastet të cilat përfshijnë asetet e ruajtura në formë elektronike, baza ligjore kur ato mund të paraqiten si dëshmi është e njëjtë si për të gjitha format e tjera të provave elektronike, siç është parashikuar në Kodin e Procedurës Penale⁵⁸, me të njëjtat rregulla për kthimin e kopjeve të provave elektronike të pandehurit siç është ravijëzuar më lart.

Është raportuar se është rutinë/e pritshme që një ekzaminim i provave elektronike do të kontrollonte asetet e ruajtura në formën elektronike (*p.sh.* portofolet e valutës virtuale)⁵⁹.

Është e mundur që në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, provat elektronike të sigurohen nga palët e treta. Në mënyrë specifike⁶⁰:

- Është e drejtë dhe detyrë e prokurorit që të kërkojë informacion nga organet qeveritare, kompanitë dhe personat privat dhe juridik në Bosnjë dhe Hercegovinë.
- Objektet të cilat i nënshtrohen sekuestrimit në përputhje me ligjin ose të cilat mund të përdoren si dëshmi në proceset penale do të sekuestrohen dhe kujdestaria e tyre do të sigurohet në përputhje me vendimin e gjykatës. Mandati për sekuestrim do të lëshohet nga gjykata në kërkesë të prokurorit ose në kërkesë të zyrtarëve të autorizuar pas miratimit nga prokurori.
- Kushdo që zotëron objekte të tilla duhet t'i dorëzojë ato me kërkesë të gjykatës. Personi i cili refuzon që t'i dorëzojë këta artikuj mund të gjobitet deri në vlerën prej 50,000KM dhe mund të burgoset nëse këmbëngul në refuzimin e tij. Burgosja do të zgjasë deri sa të mos dorëzohet artikulli ose deri në përfundimin e proceseve penale, por jo më shumë se 90 ditë.

⁵⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 35).

⁵⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 36).

⁵⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 37).

⁵⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 39).

⁶⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë Shtetërore për Hetime dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republika Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 40).

- Zyrtari përgjegjës në një organ shtetëror ose entitet ligjor do të trajtohet në të njëjtën mënyrë.
- Kjo do të vlejë edhe për të dhënat e ruajtura në një kompjuter ose pajisje të ngjashme për përpunimin automatik ose elektronik të të dhënave. Gjatë marrjesmarrjes të të dhënave të tilla, vëmendje e veçantë do të tregohet në lidhje me rregulloret mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të caktuara. Një dëftesë do të lëshohet për objektet e sekuestruara.
- Masat e detyrueshme nuk mund të zbatohen ndaj të dyshuarve ose personave të akuzuar të cilët janë të përfshirë nga detyrimi për të dëshmuar.

Të gjitha provat, duke përfshirë edhe provat nga palët e treta, duhet të sigurohen me urdhër të gjykatës. Nëse një palë e tretë dëshiron që të bashkëpunojë, është e mundur që palët e treta të ofrojnë të dhëna përmes bashkëpunimit në vend të masave detyruese⁶¹. Nëse të dhënat sigurohen nga palët e treta, ose me asistencën e tyre, është e mundur që atyre t'iu kërkohet që ta ruajnë konfidencialitetin e kësaj çështjeje⁶². Në rastet kur një person privat raporton një krim në lidhje me provat elektronike, do të ndiqen procedurat e njëjta në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, për mbledhjen e këtyre provave⁶³.

Në rastet që kanë të bëjnë me dëshmi elektronike të siguruara nga një shtet tjetër, aplikohet procedura e asistencës juridike ndërkombëtare dhe ajo rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga traktatet ndërkombëtare. Sipas Nenit 274(2) dhe (3) të KPP të BH, për të vërtetuar përmbajtjen e shkrimit, regjistrimit ose fotografimit, kërkohet shkrimi, regjistrimi apo fotografimi origjinal përveç nëse është parashikuar ndryshe nga Kodi i Procedurës Penale. Një kopje e certifikuar e origjinalit mund të përdoret si dëshmi, ose kopja e vërtetuar si e pandryshuar në raport me origjinalin. Termi "origjinal" i referohet një shkrimi, regjistrimi ose një ekuivalenti të ngjashëm që e ka për synim efektin e njëjtë nga një person që e shkruan, regjistron apo publikon atë. "Origjinali" i një fotografie përfshinë negativin ose çdo kopje nga ai. Nëse të dhënat janë ruajtur në një kompjuter apo pajisje të ngjashme automatike për përpunimin e të dhënave, çdo shtypje ose produkt i lexueshëm me të shikuar konsiderohet si "origjinal" (Neni 20(1)(g) i KPP të BH)⁶⁴.

Disa probleme që burojnë nga ligji (ose mungesa e tij), u theksuan në rastet që e përfshijnë dëshminë elektronike, përkatësisht:

- Problemet në interpretimin e termit "dëshmi origjinale".⁶⁵

⁶¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 40(b)).

⁶² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 41).

⁶³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 42).

⁶⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës së Prokurorit Federal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 43).

⁶⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 4).

- Ekzistojnë dy përjasje të ndryshme ndaj provave elektronike. E para është se pajisjet që përmbajnë dëshmi kompjuterike mblidhen si dëshmi në bazë të urdhrin të gjykatës në pajtim me Nenin 51 të KPP të BH në praninë e avokatëve dhe të dyshuarve, dhe në këtë procedurë krijohet një imazhim i ekspertizës. Imazhimet e ekspertizës ligjore më pas analizohen në bazë të urdhrin të prokurorit për vlerësim nga ekspertët (Neni 96 i KPP të BH). Përjasja e dytë është se pajisjet që përmbajnë dëshmi kompjuterike mblidhen si dëshmi në bazë të një urdhri të gjykatës për kontrollim (Neni 51 i KPP) dhe rrjedhimisht prokurori e përgatit urdhrin për analizë nga ekspertët (Neni 96 i KPP).⁶⁶
- Në KPP të BH, kontrollimi i provave elektronike nuk përshkruhet dhe kjo bën që gjyqtarët të urdhërojnë një kontroll në vend të ekzaminimit të ekspertizës ligjore. Kjo mund të zgjidhet nëse ligji do të shpjegonte kontrollin e provave elektronike.⁶⁷
- Ky ligj nuk e përshkruan si duhet trajtimin e provave elektronike.⁶⁸

Për më tepër, kërkimi i mëtejshëm tregon se artikujt e sekuestruar sipas Nenit 51 të KPP të BH, një urdhri për kontrollin e objekteve (paragrafi 1), një urdhri për kontrollin e objekteve të lëvizshme (telefonave celularë, kompjuterëve, serverëve (paragrafi 2), sipas Nenit 65, një urdhri për konfiskimin ose sekuestrimin e përkohshëm, pa një urdhër sipas Nenit 66, trajtohet si në vijim:

- Gjatë kontrollimit, në të cilin objektet sekuestrohen, duke i përfshirë ato që përmbajnë dëshmi kompjuterike, krijohet një regjistër, lëshohen certifikata për sekuestrimin e provave, më pas oficerët policorë e shkruajnë një raport për seancën gjyqësore dhe provat e sekuestruara (duke përfshirë provat kompjuterike) i dorëzohen gjykatës kompetente ku ruhen provat.
- Prokurori ia dorëzon një kërkesë gjykatës për largimin e provave nga magazina e objektit të gjykatës.
- Zyra e Prokurorit e organizon hapjen dhe identifikimin e provave sipas Nenit 71 të KPP të BH. Ekziston detyrimi që të lejohet prania e avokatëve dhe të paditurve gjatë hapjes së provave, të cilat shpëtohen, identifikohen dhe ri-paketohen. Një regjistër i plotë i këtyre veprimeve përgatitet.
- Pas hapjes dhe identifikimit të provave, prokurori ia ofron provat policisë dhe organizatave të tjera përkatëse për analizë.

Pas hapjes ose identifikimit të objekteve që përmbajnë dëshmi kompjuterike, ekzistojnë praktika të ndryshme për analizimin e provave kompjuterike. Praktika që është zbatuar në nivel Shtetëror gjatë tetë viteve të fundit, është se pas "hapjes së provave" prokurori e lëshon një urdhër për ekspertizë ligjore në pajtim me Nenin 96 të KPP të BH. Praktika e re që është themeluar në Kantonin e Sarajevës dhe në nivelin Shtetëror dhe që gradualisht është praktikuar nga prokurorët është se pasi të jetë kryer sekuestrimi, hapja dhe identifikimi, prokuroria sërisht i kërkon gjykatës që të lëshojë një urdhër për kontrollin e objekteve të lëvizshme (si ato që përmbajnë dëshmi kompjuterike) në pajtim me Nenin 51, paragrafin 2.

Kontrollimet e tilla të "sendeve të lëvizshme" organizohen në objektet e Zyrës së Prokurorit ose policisë. Zyrtarët policorë, ekspertët e ekspertizës ligjore, teknikët penalë, dy dëshmitarë, të dyshuarit, policia gjyqësore dhe avokatët janë të pranishëm.

Duke qenë se nuk ka legjislacion ose praktikë të shkruar, nganjëherë prokurorët kërkojnë që kompjuteri të ndizet dhe të kontrollohet për dëshmi të caktuara kompjuterike të cilat më pas

⁶⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Agjencisë Shtetërore për Hetim dhe Mbrojtje të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 4).

⁶⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 4).

⁶⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndhimë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 4).

regjistrohen në media optike (CD, DVD). Në rastet e tjera, një hard disk nxirret dhe bëhet një kopje e ekspertizës e diskut e cila regjistrohet në një disk të jashtëm.

Si rezultat i praktikës aktuale janë paraqitur një sërë çështjesh, si në vijim:

- Ndonëse KPP i BH nuk e parasheh praninë e dy dëshmitarëve gjatë kontrollimit të provave, disa prokurorë e kërkojnë praninë e dy dëshmitarëve;
- Në rastet penale që përfshijnë disa të dyshuar dhe një numër të madh të kompjuterëve dhe telefonave celularë, një numër i madh i personave (oficerë policorë, ekspertizë ligjore, teknikë penalë, avokatë, të dyshuar, zyrtarë gjyqësorë, dëshmitarë) janë të pranishëm që në fillim të kontrollimit të provave. Kur të dyshuarit janë në paraburgim, policia gjyqësore duhet t'i transportojë ata.
- Gjatë kontrollimit të telefonave mobil, shpesh duhet të rimbushen bateritë, dhe të gjithë duhet të presin rimbushjen e baterive.
- Shpesh ndodh që pas ditës së parë në një kontrollim të provave, asnjë prej personave shtesë nuk paraqitet, ndonëse ata më vonë janë të detyruar që ta nënshkruajnë raportin e kontrollimit. Kjo shihet si mohim i dobive të pranisë së këtyre njerëzve gjatë kontrollimit.
- Gjatë kontrollimit, nuk është e mundur që të kryhet një analizë e plotë e ekspertizës ligjore të të gjitha provave kompjuterike, dhe kjo është arsyeja pse prokurorët shpesh e kërkojnë rishikimin nga një ekspert, në pajtim me Nenin 96, paragrafin 2, gjë që shpesh rezulton në punë të dyfishtë.
- Afati kohor për ekzekutimin e urdhrit është 15 ditë në rast të çështjeve të shkallës së madhe. Shpesh policia është e detyruar të kërkojë shtyrjen e afatit për ekzekutimin e urdhrit (ligji nuk e qartëson nëse lejohet shtyrja e afatit) ose nganjëherë afati është i shkurtër, çka rrezikon të rezultojë me refuzimin e provave nga gjykata.

Praktika e ndezjes së kompjuterëve dhe kontrollimit të të dhënave është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare dhe potencialisht mund të bëjë çdo dëshmi të siguruar si të papranueshme. Fakti se nuk ka procedura të shkruara në KPP apo aktet nënligjore është problematik, pasi prokurorët nuk kanë udhëzime si të veprojnë, dhe policia, e cila e kundërshton këtë praktikë, nuk ka bazë ligjore në të cilën mund të bazohet.

Praktika origjinale e prokurorit për të lëshuar një urdhër për ekspertizë ligjore në pajtim me Nenin 96 të KPP të BH, çon në respektimin e procedurave korrekte të ekspertizës ligjore, dhe është opsioni më i preferuar. Përmbi 350 çështje janë përpunuar në këtë mënyrë, dhe asnjëherë nuk janë paraqitur probleme me pranueshmërinë.

Ekziston potenciali që praktikat e prokurorëve që insistojnë që kompjuterët të ndizen dhe kontrollohen, pa mbrojtjen që e ofrojnë procedurat korrekte të ekspertizës ligjore, do të çojnë në shpalljen e provave kompjuterike si të papranueshme në të ardhmen.

Një rekomandim i dhënë në përgjigjet e pyetësorit, ishte krijimi i procedurave të sakta me shkrim për masat ndaj provave elektronike (sigurimi, konfiskimi, ekzaminimi, kontrollimi, mbajtja, ruajtja, afatet) të gjitha me qëllim të vërtetimit të ligjshmërisë së marrjesmarrjes të provave të tilla⁶⁹. Një rekomandim i ngjashëm është dhënë nga zbatuesit e anketuar të ligjit, se duhet të specifikohet një procedurë për veprimet në vijim me provat kompjuterike: mbledhjen, ruajtjen, analizimin, shkëmbimin, paraqitjen në gjykatë, bashkëpunimin me sektorin privat⁷⁰. Një rekomandim i ngjashëm është dhënë nga hetuesit e ekspertizës ligjore kompjuterike zbatues të ligjit, se është e nevojshme që të zhvillohen udhëzime kombëtare për punën me provat elektronike (si të

⁶⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 45).

⁷⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Srpska (pyetja 45(b)).

sekuestrohen, si të ruhen, si të dëshmohet integriteti, si të bëhet analiza e ekspertizës ligjore). Udhëzimet e tilla duhet të detyrojnë mbledhjen e fjalëkalimeve për telefonat celularë dhe hard disqet e koduara⁷¹. Një rekomandim i ngjashëm është dhënë nga avokatët mbrojtës, se nevojiten procedura speciale për mbledhjen dhe përdorimin e provave elektronike në procedurat civile dhe penale⁷².

Gjithashtu është rekomanduar që ligjet mbi procedurat kriminale të shpjegojnë kontrollin e provave elektronike dhe të bëjnë dallimin mes kontrollimit dhe analizës së ekspertizës ligjore⁷³.

⁷¹ Përgjigjet e pyetësorit të Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 45(c)).

⁷² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Policisë së Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës, Zyrës për Ndihmë Ligjore të Qarkut të Bërçkos të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 45(e)).

⁷³ Përgjigjet e pyetësorit të Agjencisë për Ekspertizë Ligjore të Bosnjës dhe Hercegovinës (pyetja 45(c)).

2.3. "Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë"

Përgjigjet e Pyetësorit janë dhënë nga një hetues i krimit kibernetik, një hetues i ekspertizës ligjore kompjuterike, një hetues financiar (Policia Financiare), dhe një avokat.

Neni 198 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe Ligji për Përgjimin e Komunikimeve i përmendin në mënyrë specifike provat elektronike në mesin e artikujve që mund të përbëjnë dëshmi (janë të përmendura të dhënat kompjuterike të ruajtura në kompjuter, pajisjet që përpunojnë të dhëna elektronike, pajisjet për transferimin e të dhënave, informatat e abonentëve dhe të dhënat e komunikimit).⁷⁴ Pranueshmëria e provave elektronike buron nga KPP dhe Kodi Penal.⁷⁵ Kuptohet se provat elektronike u nënshtrohen rregullave të njëjta të pranueshmërisë si çdo lloj tjetër i provave.⁷⁶

Sipas Nenit 181 (2) të KPP, kontrollimet e kompjuterëve ose rrjeteve duhet të autorizohen nga një gjykatë në pajtim me kërkesën e prokurorit publik ose, në raste të kufizuara, nga policia gjyqësore.

Çdo kontrollim i shtëpisë dhe kontrollim i një kompjuteri duhet të urdhërohet nga gjykata me një mandat me shkrim dhe të detajuar, sipas kërkesës së prokurorit publik dhe nëse ekziston rreziku nga zvarritja, sipas kërkesës së policisë gjyqësore.⁷⁷

Ekzaminimet e ekspertizës ligjore të kompjuterëve mund të autorizohen nga gjyqtari gjatë gjykimit ose nga një prokuror gjatë fazës hetimore.⁷⁸ Cilido prej tyre mund të autorizojë imazhimin e të dhënave dhe marrjet e drejtpërdrejta, të cilat duhet të përmenden në mënyrë specifike në urdhrin e gjykatës.⁷⁹ Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kërkon një kërkesë me shkrim nga prokurori publik. Të dhënat duhet t'i dorëzohen prokurorit publik brenda afatit të tij/saj.⁸⁰ Sekuestrimi mund të mbetet konfidencial.⁸¹

Neni 198 i KPP parasheh sekuestrimin e përkohshëm të të dhënave kompjuterike, ku përfshihen "të dhënat e ruajtura në një kompjuter dhe pajisjet e ngjashme për përpunimin automatik apo elektronik të të dhënave, pajisjet për grumbullimin e të dhënave, të dhënat e bartësit dhe informacionin për abonuesin në të cilin ka akses ofruesi i shërbimit".⁸² Ky informacion duhet t'i dorëzohet prokurorit publik brenda afatit të shënuar në kërkesën me shkrim. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të vendosë, pas propozimit nga prokurori publik, që të imponojë mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjitha të dhënave kompjuterike por, jo për më shumë se 6 muaj. Të dhënat do të kthehen me të skaduar periudha "përveç nëse ato janë të përfshira në kryerjen e një vepre penale të Dëmtimit dhe aksesit të paautorizuar në një sistem kompjuterik siç është parashikuar në Nenin 251, Mashtrimi Kompjuterik nga Neni 251-b dhe Falsifikimi Kompjuterik sipas Nenit 379-a, të gjitha këto të parashikuara në Kodin Penal; ato janë përfshirë në porositjen e një krimi tjetër me asistencën e kompjuterëve; dhe përveç nëse ato do të përdoren si dëshmi për një krim".⁸³ Vendimi i gjyqtarit të procedurës penale mund të apelohehet nga personi i cili e përdor kompjuterin

⁷⁴Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 1a. Përveç nëse është përmendur ndryshe, të gjitha citimet në këtë pjesë janë nga Kodi i Procedurës Penale.

⁷⁵Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 1b.

⁷⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 1b.

⁷⁷Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 5; Neni 181 (2) i KPP.

⁷⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 6.

⁷⁹Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 7, 8, 11 dhe 12.

⁸⁰ Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 9 dhe 10; Neni 198 (1) i KPP.

⁸¹Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 15.

⁸² Neni 198 (1) i KPP.

⁸³ Neni 198 (2) i KPP.

dhe nga personi i cili e ofron shërbimin brenda 24 orëve; sidoqoftë, apeli nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.⁸⁴

Hetuesit duhet që t'i sekuestrojnë objektet fizike për t'i siguruar të dhënat.⁸⁵ Neni 184 i KPP e parasheh "kontrollin e një sistemi kompjuterik dhe të të dhënave kompjuterike: (1) Me kërkesë të agjentit përmbarues të urdhrit, personi i cili e përdor kompjuterin ose që ka akses në të ose në një pajisje tjetër apo regjistruar të të dhënave është i detyruar që t'ua sigurojë atyre aksesin si dhe që të ofrojë lajmërimin e nevojshëm për realizimin pa probleme të qëllimit të kontrollimit.

- (1) Me kërkesë të agjentit përmbarues, personi i cili e përdor kompjuterin ose që ka akses në të se në një pajisje tjetër apo bartës të të dhënave do të merr masa menjëherë për të parandaluar shkatërrimin apo ndryshimin e të dhënave.
- (2) Personin që e përdor kompjuterin ose që ka akses në të ose në një pajisje tjetër apo regjistruar të të dhënave, i cili nuk vepron në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij Neni, dhe për këtë nuk e ka një arsytim të qëndrueshëm, gjyqtari i procedurës paraprake do ta dënojë në përputhje me dispozitat e Nenit 88, paragrafi (1), të këtij Ligji".

Hetuesit i respektojnë procedurat standarde të veprimit për sekuestrimin e provave elektronike dhe për ekspertizën ligjore kompjuterike; po ashtu ekziston një udhëzues për punën me Ofruesit Shumëkombësh të Shërbimeve të Internetit dhe një udhëzues për prokurorët.⁸⁶ Asetet e mbajtura në formë elektronike, trajtohen njëjloj si provat e tjera elektronike, por kontrollimi i tyre nuk është i zakonshëm.⁸⁷

Gjykata e cila e urdhëron ekzaminimin e ekspertizës ligjore e përcakton edhe afatin për ta bërë këtë. Afati për ekzaminim mund të shtyhet për arsye të forta të paraqitura nga eksperti. Provat mund të mbahen nga qeveria gjatë periudhës e cila është përmendur në urdhrin për ekzaminimin e ekspertizës ligjore por, jo për më shumë se gjashtë muaj.⁸⁸

Përdorimi i ekspertëve kombëtarë dhe të huaj është i rregulluar me KPP. Një individ i huaj, i cili i plotëson kualifikimet për të kryer një ekzaminim të ekspertizës ligjore në përputhje me ligjet e "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë", ose një institucion privat me kualifikime të tilla, mund të emërohet për të kryer ekzaminimin me kusht që asnjë ekspert i duhur nuk gjendet në vend, sipas Nenit 198 të KPP:⁸⁹

"(1) Opinioni i një eksperti do të përcaktohet kur duhet të sigurohen gjetjet dhe opinioni i një personi i cili i ka njohuritë e duhura të ekspertit për të përcaktuar apo vlerësuar një fakt të rëndësishëm. Ekspertiza, zakonisht, kryhet nga ekspertët në regjistrin e dëshmitarëve ekspertë. (2) Ekspertiza do të caktohet me urdhër me shkrim. (3) Gjatë procedurës paraprake, urdhri do të kalohet nga prokurori publik, dhe do të aprovohet gjykata gjatë seancës kryesore, në pajtim me Nenin 394, paragrafi 2 i këtij Ligji. (4) Urdhri do të përmendë se në lidhje me cilat fakte zhvillohet një raport i ekspertit dhe kujt i besohet ai. (5) Nëse ekziston një strukturë e arsimit të lartë për një organ të caktuar ekspertize, një institut shkencor ose një institut ekspertize apo një raport ekspertize mund të zhvillohen në kuadër të organit administrativ, mendimet e tilla të ekspertëve, posaçërisht ato më të ndërlikuarat, do t'u besohen, si rregull, institucioneve apo organeve të tilla.

⁸⁴ Neni 198 (3) i KPP.

⁸⁵Prezantimi i delegatëve maqedonas gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

⁸⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 13; diskutimi gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

⁸⁷Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 37 dhe 39.

⁸⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 14 dhe 17. Sidoqoftë, gjatë diskutimit në seminarin rajonal në Bukuresht, delegatët komentuan se mund të mos ketë kufizim, varësisht nga krimi, dhe se ekzaminimi mund të zgjasë për vite të tëra.

⁸⁹Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 16.

Nëse gjetjet e ekspertit dhe opinionin e një organi administrativ shtetëror bashkëngjiten si dëshmi nga prokurori publik, dhe mbrojtja e kundërshton ato, atëherë gjykatës mund t'i propozohet që të urdhëroj një raport ekspertizë, i cili do të përgatitet nga një institucion apo organ tjetër. (6) Si rregull, një ekspert do të emërohet për ekspertizën, dhe nëse ekspertiza është e ndërlikuar, atëherë mund të emërohen dy apo më shumë ekspertë. (7) Në mënyrë të veçantë, për një person me vendbanim jashtë shtetit mund të emërohet një ekspert ose një institucion i huaj profesional i cili, në përputhje me ligjet e shtetit amë, i plotëson kërkesat për kryerjen e raporteve të ekspertizës, nëse nuk ekziston një strukturë e arsimit të lartë, institucion shkencor apo ekspert në institucionet e Republikës së Maqedonisë, pronar i vetëm - ekspert apo shoqëri tregtare e regjistruar për të dhënë dëshmi të ekspertit, për lloje të caktuara të ekspertizës. (8) Organi i përmendur në paragrafin (3) të këtij Neni i cili e ka urdhëruar opinionin e ekspertit pas opinionit të siguruar paraprakisht nga eksperti, do të përcaktojë afatin për ekspertizën dhe për dorëzimin e gjetjeve dhe opinionin, dhe kjo periudhë mund të shtyhet vetëm me kërkesë të arsyetuar nga eksperti".⁹⁰

Për të pranuar provat elektronike në gjykim, kërkohen praktikat më të mira për kontrollin, sekuestrimin dhe analizimin e të dhënave dhe të pajisjeve, duke përfshirë edhe një zinxhir të ditarit të kujdestarisë, foto për dokumentimin e procedurave, dhe një raport i cili përfshin edhe vlerat 'hash' (vlerat identifikuese të të dhënave).⁹¹ Vërejtjet tipike të mbrojtjes në përgjithësi i përfshijnë përjashtimet procedurale: Metodatat për kontrollin dhe sekuestrimin, mjetet dhe metodatat e përdorura për marrjen e të dhënave, dhe problemet me pjesët elektronike për analizim - për shembull nëse mediat janë sterilizuar.⁹² Provat elektronike prezantohen nga eksperti.⁹³

Të drejtat e të pandehurit mbrohen në disa mënyra. I pandehuri ose, më mirë, avokati i të pandehurit mund të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit me kërkesë të mbrojtjes nëse kontrollimi zhvillohet në rezidencën e të pandehurit. Mbrojtja nuk do të jetë e pranishme gjatë imazhimit apo ekzaminimit të ekspertizës ligjore.⁹⁴ I pandehuri ka të drejtë që të ketë një kopje të të dhënave si për ekzaminim ashtu edhe për përgatitjen e çështjes.⁹⁵

Pajisjet dhe të dhënat i kthehen pronarit (duke përfshirë të pandehurin) në fund të çështjes. Sidoqoftë, artikujt nuk do të kthehen kur vërtetohet se provat janë përdorur për të kryer një krim ose vet zotërimi i tyre është i paligjshëm.⁹⁶

Të dhënat mund të sigurohen nga palët e treta qoftë përmes bashkëpunimit vullnetar ose mandatit ligjor sipas Neneve 198 (1) dhe 196 (1) të KPP. Çështja mund të mbetet konfidenciale. Për të siguruar të dhëna nga palët e treta përmes bashkëpunimit, prokurori do të dërgojë një kërkesë zyrtare elektronike. Nëse një person privat e raporton një krim, sipas KPP mund të merren edhe të dhënat e tij/saj. Prokurori publik do të sigurojë një urdhër për kontroll nga gjykata.⁹⁷

⁹⁰Prezantimi i delegatëve maqedonas gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

⁹¹Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 18 - 21.

⁹²Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 29.

⁹³Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 34.

⁹⁴Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 23-25.

⁹⁵Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 22 dhe 26. Një nga të anketuarit ka deklaruar se i pandehuri nuk ka të drejtë që të ketë një kopje të të dhënave për të përgatitur çështjen e tij/saj, por duke i pasur parasysht përgjigjet nga po i njëjti person i anketuar, kjo përgjigje duket të jetë një gabim.

⁹⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 14, 27 dhe 28.

⁹⁷Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 15, 40-43. Njëri nga të anketuarit deklaroi se të gjitha procedurat janë detyruese.

Të dhënat sigurohen nga palët e treta ndërkombëtare përmes bashkëpunimit policor ndërkombëtar, bashkëpunimit me Ofruesit Shumëkombësh të Shërbimeve dhe kërkesave të Përbashkëta të Asistencës Ligjore.⁹⁸

Të anketuarit nga pyetësorit në përgjithësi ishin të mendimit se vendi i tyre kishte përvojë në përdorimin e provave elektronike në gjykatë. Sidoqoftë, kishte dallim në mendime për sa i përket pjesës së gjykatave të cilat i kanë pajisjet e nevojshme si dhe në lidhje me shkallën e përvojës së gjykatave me analizat e ekspertizës elektronike. Dy të anketuar mendonin se përvoja e ekspertizës ligjore e gjykatave ishte e kufizuar dhe se gjykatat kanë prirje që të caktojnë afate për analiza të cilat ishin tepër të shkurtra. Njëri prej të anketuarve, ka raportuar shumë raste në të cilat inspektuesit ishin urdhëruar që të nxirrin (me sa duket që t'i printonin) deri në terra bajt të të dhënave për t'ia dorëzuar prokurorit publik.⁹⁹

Delegatët rekomanduan më shumë pajisje, personel dhe trajnime për provat elektronike për të gjitha llojet e zyrtarëve të drejtësisë.

⁹⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 40.

⁹⁹Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 30-33.

2.4. Mali i Zi

Përgjigjet e pyetësorit u dhanë nga një gjykatës, një avokat mbrojtës, përpara seminarit rajonal në Bukuresht. Përgjigjet nga një prokuror, hetuesi i krimit kibernetik dhe një ekspert i ekspertizës ligjore kompjuterike nga Zyra Speciale e Prokurorit Publik, u morën pas aktivitetit. Ka dallime në përgjigjet e dhëna nga kontribuuesit dhe aty ku ato ekzistojnë, është përfshirë çdo përgjigje dhe kontribuuesit janë identifikuar me shënime.

Neni 75 - Neni 163 i Kodit të Procedurës Penale i trajton veprimet e provave dhe kategoritë e provave. Ato përfshijnë:

- Kontrollin e hapësirës së banimit, lokaleve të tjera, artikujve të lëvizshëm dhe personave
- Sekuestrimin e përkohshëm
- Dëshminë e të akuzuarit
- Provat e dëshmitarëve
- Ekzaminimin e skenës së krimit dhe rikonstruktimin e ngjarjes
- Ekzaminimet e ekspertizës ligjore
- Fotot dhe shiritat audio-vizual
- Survejimin.

Provat elektronike nuk janë përkufizuar në Kodin e Procedurës Penale, ashtu si edhe asnjë prej rregullave specifike për pranueshmërinë e tyre. Sipas një përgjigjeje, provat elektronike as nuk janë as të përfshira e as të përjashtuara nga legjislacioni. I takon secilit gjykatës që të vendosë për këtë çështje në secilin rast.

Një shembull i një rasti kur nuk ka pasur asnjë pajisje fizike apo objekt për të sekuestruar, është kur një gjykatës i ka kërkuar YouTube që të japë të dhëna në një çështje civile. YouTube nuk u bind sepse kërkesa nuk ishte dorëzuar në formën e duhur, dhe kështu rasti u mbyll pa provat.¹⁰⁰

Të anketuarit në pyetësor u përgjigjën pozitivisht në Pyetjen 1b, duke konfirmuar se ligji thotë se provat elektronike janë të pranueshme në rastet penale, përveç avokatit mbrojtës.¹⁰¹ Mungesa e ligjeve që i mbulojnë provat elektronike shkakton probleme, sepse nuk është e mundur që të përcaktohet nëse provat elektronike janë të pranueshme, duke qenë se nuk ka asnjë procedurë për marrjen dhe përpunimin e tyre.¹⁰²

Një shembull i vështirësisë së analizimit të përgjigjeve të Malit të Zi është dallimi në përgjigjet e dhëna, ku disa janë diametralisht të kundërta. Tabela në vijim e jep një shembull të tillë.

| Pyetje | Avokati | Njësia e krimit kibernetik | Prokurori | Gjyqtari | Eksperti i ekspertizës ligjore |
|--------|---------|----------------------------|-----------|----------|--------------------------------|
| 1 (b) | Jo | Po | Po | Po | Po |
| 1 (c) | Jo | Po | Po | Jo | Po |
| 1 (d) | Jo | Po | Po | Jo | Po |

¹⁰⁰Përgjigjet e pyetësorit - avokati (pyetja 10).

¹⁰¹ Shih Shtojcën 4.2.

¹⁰²Përgjigjet e pyetësorit - avokati (pyetjet 1 deri në 4).

| | | | | | |
|-------|----|----|----|----|----|
| 1 (e) | Jo | Po | Po | Jo | Po |
|-------|----|----|----|----|----|

Çuditërisht, përgjigjet e Pyetjes e 2, e cila është relevante vetëm nëse pranueshmëria e provave elektronike nuk është e parashikuar me ligj, janë dhënë nga të gjithë të anketuarit, përveç avokatit i cili e rithekson se asnjë ligj nuk e mbulon këtë temë dhe se secila gjykatë vendos për këtë çështje. Përgjigjet e tjera pohojnë se ajo parashihet me Kodin e Procedurës Penale, edhe pse ndonëse mungon baza për të vendosur mbi pranueshmërinë, ndaras nga konsideratat e rregullave të përgjithshme të pranueshmërisë.

Pyetjet 1b dhe 2 të Pyetësorit, në veçanti duket se kanë shkaktuar pak huti për shkak se pyetja 1b pyet specifikisht nëse ligji e mbulon pranueshmërinë e provave elektronike. Përgjigjet pozitive, duket se përgjigjen në një pyetje më të përgjithshme praktike nëse ato vlerësohen si të pranueshme në gjykatë.

Kontradikta të mëtejme paraqiten në përgjigjet e Pyetjes 4, e cila merret me problemet e shkaktuara nga ligji apo mungesa e tij. Në mesin e përgjigjeve përfshihen:

- "Kodi i Procedurës Penal nuk i konsideron provat elektronike si lloj të posaçëm të provave, në lidhje me faktin se sipas këtij ligji, kontrollimi i provave elektronike konsiderohet si kontrollim i sendeve të lëvizshme". [prokurori] "Kodi i Procedurës Penale nuk i trajton provat elektronike (kompjuterët dhe pajisjet e ngjashme për përpunimin automatik të të dhënave me të cilat kompjuteri është i lidhur) si një lloj të posaçëm të provave. Provat elektronike trajtohen në Kodin e Procedurës Penale si sende të lëvizshme". (Neni 75 paragrafi 2)" [eksperti i ekspertizës ligjore kompjuterike]
- "Po, i konsideron, sepse nuk është e mundur që të përcaktohet nëse provat e këtij lloji janë të pranueshme apo jo kur kemi parasysh se nuk ka procedura për marrjen e tyre". [avokati]
- "Nuk ka probleme". [gjyqtari]
- "Po, krijon probleme, sepse jo të gjithë oficerët e zbatimit të ligjit kanë shkollim të mjaftueshëm për mbledhjen e provave kompjuterike dhe nuk kanë kompetenca për sjelljen e reaguesve të parë, dhe për shkak se mbledhja e provave nuk parashihet nga ndonjë Ligj përveç Kodit të Procedurës Penale, kjo krijon mungesën e kontrollimit dhe sekuestrimit të provave të mira elektronike" [hetuesi i krimit kibernetik].

Shqyrtimi i KPP nuk gjeti asnjë përkufizim të provave elektronike. Gjenden referime të shumta për komunikimet elektronike dhe përdorimin e dokumenteve elektronike në forma të ndryshme, por jo si dëshmi.

Neni 75 i KPP thotë: "(1) Kontrollimi i rezidencave dhe hapësirave të tjera të personave të akuzuar apo personave të tjerë si dhe i sendeve të tyre të lëvizshme jashtë rezidencave mund të kryhet nëse ka dyshime të bazuara se gjatë zhvillimit të kontrollimit kryerësi do të kapej ose që do të gjendeshin gjurmët e veprës penale ose objekteve relevante për procesin penal.

(2) Kontrollimi i sendeve të lëvizshëm në kuadër të kuptimit të paragrafit 1 të këtij Neni do të përfshijë kontrollin e kompjuterëve dhe pajisjeve të ngjashme për përpunimin automatik të të dhënave me të cilat është i lidhur kompjuteri. Me kërkesë të gjykatës, personi i cili e përdor kompjuterin do të mundësojë aksesin në kompjuter dhe pajisje të lëvizshme për ruajtjen e të dhënave të cilat janë përdorur për të ruajtur informacione relevante për objektin e kërkimit (disqet, USB disqe flash, USB hard disqe, disketa, shirita dhe të ngjashme), si dhe të jep informacionin e nevojshëm mbi përdorimin e kompjuterit. Personat të cilët refuzojnë që të veprojnë kështu, ndonëse nuk ekzistojnë arsyet e përmendura në Nenin 111 të Kodit aktual, mund të dënohen në pajtim me Nenin 85, paragrafin 3 të Kodit aktual".

Me sa duket ky Nen është baza mbi të cilën janë dhënë disa nga Pyetjet 1 deri në 4.

Kontrollimi i kompjuterëve dhe rrjeteve, ekzaminimi i ekspertizës ligjore i pajisjeve të sekuestruara, imazhimi i të dhënave dhe zhvillimi i drejtpërdrejt i marrjes së të dhënave, bazohen në urdhra të gjykatave, sipas kërkesës së prokurorit.¹⁰³ Përgjigjja e prokurorit dallon dhe ka mundësi që pasqyron një keqkuptim të pyetjeve, pasi përgjigjja ndërlidhet më shumë me identifikimin e atyre që i kryen aktivitetet më shumë se me ata që i autorizojnë ato.

Çështja nëse kërkohet sekuestrimi i objekteve fizike në vend të të dhënave, vetëm sa krijon përgjigje të ndryshme. Dy përgjigje sugjerojnë se çështja nuk është e rregulluar qartë (prokurori dhe eksperti i ekspertizës ligjore). Përgjigjja tjetër e vetme është dhënë nga hetuesi i krimeve kibernetike dhe ajo sugjeron se kërkohet sekuestrimi i objekteve fizike.¹⁰⁴

Që të tre të anketuarit e kanë dhënë një shembull se si ata i kanë trajtuar rastet kur nuk ka pasur objekte fizike për t'i sekuestruar. Ai përfshin marrjen e një urdhri nga gjykata për të kontrolluar një llogari të postës elektronike online. U krijua një kopje rezervë e të dhënave si dhe u krijua një kod hash (vlerë numerike identifikuese) e provës. Aksesi në llogari u sigurua duke i përdorur kredencialet e pronarit të llogarisë.¹⁰⁵

Çështja e aftësisë për të imazhuar ose zhvilluar analiza të ekspertizës ligjore të drejtpërdrejta në vend, çon në një sërë të përgjigjeve që shtrihen nga "Jo", në "nuk është e rregulluar mjaftueshëm", deri tek "Po, në bazë të KPP". Mospërputhja në përgjigje, mbase tregon se kjo fushë kërkon më shumë qartësim.¹⁰⁶

Me sa duket, edhe pse nuk ka udhëzime kombëtare për mbledhjen dhe trajtimin e provave elektronike, ekzistojnë disa udhëzime të cilat janë në dispozicion të oficerëve policorë në nivelin praktik.¹⁰⁷

Provat ruhen vetëm nga policia gjatë kohës së ekzaminimit të ekspertizës ligjore të materialit. Më pas, ato i përcillen prokurorit i cili është përgjegjës për ruajtjen e tyre. Provat e sekuestruara ruhen në magazina kompjuterike të të dhënave. Në rastin specifik të Zyrës së Prokurorit Special Shtetëror, materialet e provave i ruan Shërbimi Profesional për Dëshmi Kompjuterike. Materiali ruhet deri në nxjerrjen e aktakuzës, dhe nëse provat sugjerojnë se nuk është vërtetuar kryerja e veprës, nuk ruhen për më shumë se gjashtë muaj. Nuk ka pikëpamje të përbashkët, pasi kompetenca për sekuestrimin e provave elektronike mbetet konfidenciale.¹⁰⁸

Sipas Nenit 137 (4) të KPP dhe Nenit 3 (2) të Ligjit mbi Ekspertët Gjyqësorë, është e mundur që të sigurohet asistencë nga palët e treta nga jashtë shtetit për të zhvilluar ekzaminime kompjuterike të ekspertizës ligjore. Një afat tre mujor për zhvillimin e ekzaminimeve kompjuterike të ekspertizës ligjore u theksua nga hetuesi i krimeve kibernetike.¹⁰⁹

Për të vërtetuar se provat elektronike janë inspektuar, janë ruajtur në mënyrë korrekte dhe nuk janë ndryshuar nga ekspertiza ligjore, ndërmerren hapat në vijim:

¹⁰³ Përgjigjet e pyetësorit - avokati, hetuesi i krimit kibernetik dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 5 deri në 8).

¹⁰⁴ Përgjigjet e pyetësorit - avokati, hetuesi i krimit kibernetik dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetja 9).

¹⁰⁵ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori, hetuesi i krimit kibernetik dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetja 10).

¹⁰⁶ Përgjigjet e pyetësorit - avokati, prokurori, hetuesi i krimit kibernetik dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 11 dhe 12).

¹⁰⁷ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori, hetuesi i krimit kibernetik dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetja 13).

¹⁰⁸ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 14 dhe 15).

¹⁰⁹ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori, eksperti i ekspertizës ligjore dhe hetuesi i krimit kibernetik (pyetjet 16 dhe 17).

- Prokuroria lëshon një urdhër për ekzaminimin e ekspertizës ligjore ku theksohet subjekti i ekzaminimit si dhe afatet.
- Kompjuterët dhe telefonat vulosen, hapen në praninë e të pandehurit dhe dëshmitarëve. Pas imazhimit të ekspertizës ligjore të të dhënave dhe krijimit të vlerës identifikuese (hash) të të dhënave, ato vulosen sërish në praninë e të pandehurit dhe të dëshmitarëve. [eksperti i ekspertizës ligjore kompjuterike]
- Mjetet e ekspertizës ligjore dhe praktikantët e ekspertizës ligjore kompjuterike janë garanci se provat nuk do të ndryshohen (bllokuesit e të shkruarit, checksums (shifra që përfaqëson shumën e shifrave të sakta të të dhënave - verifikuesit e shifrave, etj.). [prokurori]¹¹⁰

Përdorimi i mjeteve të ekspertizës ligjore, programeve dhe pajisjeve elektronike (bllokuesve të të shkruarit, verifikuesve të shifrave, etj.) dhe raportimi sigurojnë zhvillimin korrekt të ekzaminimit të ekspertizës ligjore, mirëpo kjo nuk është e rregulluar me ligj.¹¹¹

Për të rregulluar pranueshmërinë e provave elektronike, prokurori propozon në aktakuzë që provat e analizuara elektronike të përfshihen si dëshmi, *p.sh.* të prezantohen si dëshmi gjatë seancës kryesore. Natyrisht, përpunuesit e provave kompjuterike (dëshmitarët ekspertë, Qendra e Ekspertizës Ligjore, ekspertët e trajnuar për analiza të ekspertizës ligjore) duke përdorur procedurat e ekspertizës ligjore sugjerojnë integritetin e provave, kurse pajisjet elektronike dhe programet e përshtatshme të ekspertizës ligjore e sigurojnë integritetin e vetë provave. Mbrojtja ka të drejtë që të kundërshtojë secilën dëshmi që propozohet nga prokuroria, duke përfshirë edhe provat elektronike.¹¹²

I dyshuari dhe/ose përfaqësuesi i tij e kanë të drejtën që të jenë të pranishëm gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit të provave elektronike. Personi i cili e kryen kontrollin mund ta bëjë atë në mungesë të mbrojtjes vetëm në rrethana të caktuara. I dyshuari dhe/ose përfaqësuesi i tij mund të jenë të pranishëm gjatë imazhimit të të dhënave dhe analizës së ekspertizës ligjore, ndonëse, ata rrallëherë janë të pranishëm për këtë të dytën, për shkak të kohës së gjatë që nevojitet për fazën e procesit të analizimit. Mbrojtja ka të drejtë që të ketë një kopje të secilës dëshmi të propozuar në aktakuzë. Pas marrjes së vendimit nëse duhet të ngrihet aktakuzë, objektet e sekustruara kthehen, përveç nëse ato janë përdorur për të kryer veprën penale. Në lidhje me kundërshtimet e mbrojtjes ndaj provave elektronike, një prej kundërshtimeve që mund të bëjë mbrojtja është se vetë provat nuk janë mbledhur në mënyrë të ligjshme. Në praktikë, nuk është përcaktuar shpeshësia e kundërshtimeve të tilla.¹¹³

Thuhet se gjykatat janë të mësuara me provat elektronike dhe ato i kanë pajisjet për t'u marrë me provat e tilla në gjykim. Ekziston një shërbim profesional për teknologjinë informative në gjykata, i cili ndihmon në prezantimin e provave kompjuterike dhe provave të tjera në gjykatë. Një problem që është theksuar është se gjykatat shpesh kërkojnë printimin e provave elektronike. Është interesante që të theksohet se përderisa prokuroria dhe eksperti i ekspertizës ligjore kompjuterike e shohin këtë si problem, përgjigjet nga gjyqtari sugjerojnë se nuk ka probleme. Gjyqtari mund të vendos nëse do të përjashtojë ndonjë dëshmi të propozuar nga prokuroria, në bazë të kushteve të parapara me ligj.

Gjykata i konsideron si dëshmi gjetjet dhe opinionet e ekspertit. Pala mund të kërkojë, dhe gjykata do të lejojë dhe urdhërojë, që eksperti që e ka kryer analizën të japë në deklaratë gojore në lidhje me kundërshtimet e mundshme - e cila do të dëgjohet aty për aty dhe për të dhënë qartësimet e mundshme dhe për t'u përgjigjur në pyetjet e palëve. Gjykata mund t'i kërkojë një ekspertit që të plotësojë analizën. Legjislacioni ua lejon ekspertëve, të cilët i kanë njohuritë e nevojshme profesionale dhe të cilët e ndihmojnë gjykatën, për të përcaktuar dhe vlerësuar faktet e rëndësishme.¹¹⁴

¹¹⁰ Përgjigjet e pyetësorit (pyetjet 18 deri në 20).

¹¹¹ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 18 deri në 20).

¹¹² Përgjigjet e pyetësorit - prokurori (pyetjet 21 deri në 22).

¹¹³ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 23 deri në 29).

¹¹⁴ Përgjigjet e pyetësorit - prokurori, gjyqtari dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 30 deri në 36).

Ndonëse është parashikuar që provat e aseteve në formë elektronike janë të pranueshme, nuk janë raportuar prova të këtij lloji të çështjeve.¹¹⁵

KPP e lejon marrjen e provave nga palët e treta dhe metodat për marrjen e provave të tilla varen nga rrethanat dhe lloji i çështjes. Prokuroria konsideron se kjo kërkon konfidencialitet deri në ngritjen e aktakuzës. Sikurse me veprimet e tjera, sigurimi i provave nga palët e treta bëhet me urdhër të gjykatës ose përmes Asistencës Reciproke Ligjore, nëse të dhënat ruhen jashtë shtetit.¹¹⁶

Për rastet që kanë të bëjnë me marrjen e provave elektronike nga jashtë shtetit, duhet të bëhet një kërkesë për autenticitetin e të dhënave, përmes përdorimit të metodave verifikuese të ekspertizës ligjore si verifikimi i shifrave (checksums), pasi këto janë metodat e përdorura në Mal të Zi. Gjykata mund t'i shpallë provat elektronike si të papranueshme, nëse ato nuk janë siguruar në mënyrë të pranueshme ligjore. Një shembull i tillë është kur provat janë siguruar përmes zbatimit të masave të survejimit të fshehtë pa autorizimet e duhura.¹¹⁷

Prokurori ka theksuar se duke pasur parasysh rritjen me shpejtësi të shkallës së krimit kibernetik, dhe përdorimin e shtuar të depove kompjuterike si mjete për të kryer dhe komunikuar aktivitetet kriminale, kjo fushë duhet të rregullohet në mënyrë më të detajuar sesa është rregulluar me legjislacionin aktual. Nuk janë dhënë sugjerime specifike.¹¹⁸

Kishte numër të mjaftueshëm të përgjigjeve të ndryshme ndaj pyetjeve të parashtruara në Pyetësor, për të ardhur në përfundimin se ia vlen që të shikohen çështjet rreth grumbullimit, analizimit dhe pranueshmërisë së provave elektronike në Mal të Zi. Niveli i përgjigjeve të ndryshme është i tillë sa që nevojitet formalizmi i procedurave për trajtimin e provave elektronike dhe mbrojtjen e sigurisë dhe privatësisë së të dhënave gjatë hetimeve penale.

¹¹⁵ Përgjigjet e pyetësorit – prokurori, gjyqtari dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 37 deri në 40).

¹¹⁶ Përgjigjet e pyetësorit – prokurori, gjyqtari dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 41 deri në 42).

¹¹⁷ Përgjigjet e pyetësorit – prokurori, gjyqtari dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 43 deri në 44).

¹¹⁸ Përgjigjet e pyetësorit – avokati, prokurori, gjyqtari dhe eksperti i ekspertizës ligjore (pyetjet 43 deri në 44).

2.5. Serbia

Përgjigjet e Pyetësorit janë dhënë nga një hetues i krimit kibernetik, një specialist i ekspertizës ligjore kompjuterikekompjuterike dhe një prokuror. Duhet theksuar se gjatë identifikimit të burimeve të përgjigjeve në pyetësor, shpesh kishte përgjigje të përbashkëta nga kontribuuesit e ndryshëm. Në këto raste, në shënime është përmendur kontributi i parë. Një version i rishikuar i pyetësorit u dërgua nga delegatët pas seminarit rajonal në Bukuresht, që plotëson ose qartëson disa prej përgjigjeve fillestare, dhe referimi përkatës ndaj dokumentit është bërë në mënyrën e duhur.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Serbisë metodat për marrjen e provave ndahen në kategoritë në vijim¹¹⁹:

- Marrja në pyetje e të pandehurit
- Pyetja e dëshmitarëve
- Ekzaminimi i ekspertëve
- Rindërtimi i ngjarjeve
- Kontrollimi i një personi, objekti dhe lokali
- Përdorimi i regjistrave si dëshmi
- Marrja e mostrave
- Kontrollimi i llogarive dhe transaksioneve të dyshimta (marrja e të dhënave, monitorimi i transaksioneve të dyshimta, suspendimi i përkohshëm i transaksioneve të dyshimta)
- Sekuestrimi i objekteve
- Kontrollimi
- Veprimet speciale dëshmuese (përgjimi i fshehtë i komunikimeve, survejimi i fshehtë dhe regjistrimet me audio dhe video, simulimi i (biznesit) marrëveshjeve, kontrollimi i të dhënave kompjuterike, dërgesat e kontrolluara, hetuesi i maskuar).

KPP e përkufizon një instrument si një objekt apo të dhëna kompjuterike të përshtatshme apo të destinuara si dëshmi të një fakti që do të përcaktohet gjatë procedurave. Në këtë kuptim, të dhënat kompjuterike janë të pranueshme si dëshmi elektronike në çështjet penale¹²⁰. Parakushti vetëm është që provat të jenë mbledhur në pajtim me ligjin. Nuk ka kërkesa të tjera shtesë¹²¹. Provat elektronike po ashtu janë të pranueshme në rastet civile dhe nuk ka ndonjë kërkesë shtesë për pranueshmërinë e provave elektronike në rastet civile¹²².

Neni 2 i KPP merret me përkufizimin e termave. Të dhënat elektronike përmenden në paragrafët 29 deri në 32 si në vijim:

"29) një regjistrim elektronik janë të dhënat audio, video ose grafike në formën elektronike (kompjuterikekompjuterike);

30) një adresë elektronike është një komplet i simboleve, shkronjave, numrave dhe sinjaleve të menduara për përcaktimin e origjinës së një lidhjeje;

31) një dokument elektronik është një komplet i të dhënave i cili përkufizohet si një dokument elektronik në pajtim me ligjin që i rregullon dokumentet elektronike;

32) një nënshkrim elektronik është një komplet i të dhënave i cili përkufizohet si një nënshkrim elektronik në pajtim me ligjin që i rregullon dokumentet elektronike".

¹¹⁹ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 1(a)).

¹²⁰ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 1(b)).

¹²¹ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 1(c)).

¹²² Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 1(d dhe e)).

Neni 147 i KPP iu referohet objekteve të sekuestruara dhe specifikon se aty përfshihen edhe "aparaturave dhe pajisjeve për përpunimin automatik të të dhënave dhe aparaturat në të cilat mbahen ose mund të mbahen regjistrat elektronik".

Neni 152 i KPP thotë se "kontrollimi i një rezidence ose hapësirave të tjera dhe një personi mund të bëhet nëse ka gjasa që kontrollimi të rezultojë në gjetjen e të pandehurit, gjurmëve të veprës kriminale ose objekteve me rëndësi për procedurat. Kontrollimi i një rezidence ose hapësirave të tjera apo një personi kryhet në bazë të urdhrit të gjykatës ose përjashtimit pa një urdhër, në bazë të një autorizimi ligjor. Kontrollimi i pajisjeve për përpunimin automatik të të dhënave dhe aparaturave në të cilat ruhen ose mund të ruhen regjistrat elektronik zhvillohet me urdhër të gjykatës, dhe nëse është e nevojshme, me asistencën e një eksperti asistencës".

Është identifikuar se mbledhja e provave elektronike është përkufizuar njëloj sikurse edhe kontrollimi i pronës dhe personave nga policia, gjë që në praktikë shkakton një numër të madh të problemeve procedurale. Sidoqoftë, në përgjigjet e pyetësorit nuk janë dhënë detaje të mëtejshme¹²³.

Udhëzimet për sekuestrimin e provave elektronike janë përfshirë në KPP dhe në Ligjin për Ratifikimin e Konventës mbi Krimin Kibernetik. Nuk ka udhëzime të veçanta kombëtare për këtë temë¹²⁴. Gjithsesi, ka udhëzime për policinë për sekuestrimin e provave elektronike¹²⁵.

Neni 147 i KPP thotë se "Autoriteti që e zhvillon procedurën do të sekuestrojë objektet të cilat duhet të sekuestrohen në pajtim me Kodin Penal ose të cilat mund të shërbejnë si dëshmi në proceset penale dhe do të sigurojë mbrojtjen e tyre", çka siç është përmendur më lart, mund të përfshijë "aparaturat dhe pajisjet për përpunimin automatik të të dhënave dhe pajisjet në të cilat mbahen apo mund të mbahen regjistrat elektronik".

Në rastin e sekuestrimit, kompjuterët dhe telefonat vulosen dhe ata hapen në praninë e të pandehurit dhe të dëshmitarëve. Pas krijimit të një imazhimi të ekspertizës ligjore dhe gjenerimit të vlerës identifikuese (hash) të të dhënave, ato vulosen prapë në praninë e të pandehurit dhe të dëshmitarit. Njësia e Ekspertizës Ligjore KompjuterikeKompjuterike nuk i ruan (depoziton) provat elektronike. Pas mbledhjes së provave dhe shkrimit të raportit, provat i përcillen prokurorit, ata i mbajnë vetëm raportet për t'i përdorur si dëshmi gjatë gjykimit¹²⁶. Çdo dëshmi e sekuestruar gjatë një hetimi ruhet nga prokurori, i cili i mban ato deri në parashtrimin e aktakuzës pranë gjykatës. Është përgjegjësia e prokurorisë që të sigurohet se të dhënat e sekuestruara do të mbahen të sigurta dhe në kushte të përshtatshme. Nuk ka shpjegim se çka nënkuptohet me kushtet të përshtatshme.

Nuk është dhënë asnjë detaj për procedurat për trajtimin dhe ruajtjen e provave elektronike, ndonëse policia i kanë udhëzimet e tyre për trajtimin e provave. Me sa duket, të gjitha provat policia ia përcjellë prokurorit, i cili është përgjegjës për ruajtjen e tyre deri në fillimin e gjykimit. Me sa duket, nuk ka procedura për identifikimin e kushteve të përshtatshme për ruajtjen e provave të sekuestruara ose për të siguruar ruajtjen e integritetit të provave gjatë kohës që ato janë në zotërim të prokurorit.

Në kuadër të sistemit ligjor të Serbisë, sipas Ligjit mbi të Dhënat Konfidenciale, është e mundur që të kërkohet nga sekuestrimi që të ruhet konfidencialiteti dhe të zbatohen kufizime¹²⁷.

¹²³ Përgjigjet e pyetësorit – Njësia e Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 4).

¹²⁴ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 13).

¹²⁵ Përgjigjet e pyetësorit – Njësia e Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 13).

¹²⁶ Përgjigjet e pyetësorit – Njësia e Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetjet 14 dhe 18).

¹²⁷ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 14 deri në 15 dhe 18).

Kontrollimet e kompjuterëve ose rrjeteve zhvillohen në pajtim me kushtet e përmendura në urdhrin e gjykatës. Autoriteti që është duke i zhvilluar procedurat (prokurori apo gjykata) do të urdhërojnë një ekzaminim nga eksperti, kur kërkohen njohuritë profesionale për të përcaktuar ose vlerësuar një fakt të caktuar gjatë procedurave.

Autoriteti që është duke i zhvilluar procedurat e urdhëron kryesisht një ekzaminim nga eksperti me lëshimin e një urdhri me shkrim ose me një mocion nga ndonjëra palë dhe avokati mbrojtës, dhe nëse ka rrezik të vonesës ekzaminimi nga eksperti mund të urdhërohet edhe gojarisht, me detyrimin që të hartohet një shënim zyrtar.

Imazhimi i të dhënave dhe zhvillimi i marrjes së drejtpërdrejt të të dhënave bazohen në urdhra të prokurorisë ose të gjykatës. Një njësi speciale e policisë ose dëshmitar ekspert i kryen të gjitha këto aktivitete. Në bazë të ligjeve të Serbisë është e mundur që sekuestrohen edhe të dhënat edhe objektet. Me fjalë të tjera, nuk është gjithmonë e nevojshme që të sekuestrohen pajisje fizike, kur të dhënat mund të sekuestrohen veçmas. Si imazhimi i të dhënave ashtu edhe ekspertiza ligjore e drejtpërdrejt e të dhënave mund të zhvillohen në vend¹²⁸.

Autoriteteve të Serbisë iu lejohet që të angazhojnë ekspertë nga sektori privat, një shtet tjetër apo një organizatë ndërkombëtare, nëse është e nevojshme dhe shkathtësitë e nevojshme nuk gjenden në kuadër të autoriteteve serbe. Çdo ekzaminim i provave duhet të zhvillohet pa vonesa, ndonëse nuk ka ndonjë afat kohor të parashkrimit.¹²⁹

Të gjitha kontrollimet elektronike, ekzaminimet pasuese dhe pranueshmëria e provave varen nga kryerja e veprimeve në pajtim me ligjin e Serbisë. Kjo kërkon që për secilën fazë të procesit, prokurori të aplikojë pranë gjykatës për lëshimin e një urdhri. Çdo raport që dorëzohet në lidhje me këto veprime duhet të demonstrojë pajtueshmërinë me ligjin¹³⁰.

Mbrojtja mund të kontrollojë provat e prokurorit, por vetëm pasi që i pandehuri të jetë marrë në pyetje. Zakonisht mbrojtja e kërkon ekzaminimin e një kopjeje të raporteve të ekspertizës ligjore, mirëpo mund të ndërmerret edhe aksesi në vetë dëshmi. I pandehuri ose një përfaqësues i tij mund të jenë të pranishëm gjatë kontrollimit, imazhimit dhe ekzaminimit të ekspertizës ligjore të të dhënave. Për më tepër, ata kanë të drejtë që të marrin një kopje të provave elektronike¹³¹.

Nëse gjatë një kontrollimi, gjenden objekte të cilat nuk janë të ndërlidhura me veprën penale për të cilën është zhvilluar kontrollimi, por të cilat tregojnë një vepër tjetër penale e cila mund të ndiqet penalisht kryesisht, ato do të përshkruhen në regjistër, do të sekuestrohen, dhe menjëherë do të lëshohet një dëshmi e sekuestrimit. Nëse prokurori publik gjen se nuk ka baza për të nisur proceset penale, apo nëse arsyet për të cilat objektet janë sekuestruar pushojnë së ekzistuari, dhe arsyet për sekuestrimin e tyre nuk ekzistojnë, objektet do t'i kthehen menjëherë personit prej të cilit janë sekuestruar. Në rast të zotërimit të çfarëdo materiali të paligjshëm, ai nuk do t'i kthehet personit prej të cilit janë sekuestruar.¹³²

Në mesin e kundërshtimeve të ngritura nga mbrojtja, në rastet që kanë të bëjnë me provat elektronike, në gjykimet penale në Serbi, janë këto:

- Kundërshtimi i dëshmitarëve ekspertë për sa i përket ekspertizës së tyre në atë fushë, referencat e tyre, numrin e ekzaminimeve të ekspertizës që ata i kryer deri në atë ditë.
- Gjetjet e ekspertit dhe opinionet kundërshtohen me pohimin e Mbrojtjes se është teknikisht e pamundur që qindra dokumente të fshihen në të njëjtën orë, minutë, ose në një sekondë të

¹²⁸ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 5 deri në 12).

¹²⁹ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 16 deri në 17).

¹³⁰ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 19 deri në 21).

¹³¹ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 22 deri në 26).

¹³² Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 27 deri në 28).

caktuar specifikisht, e madje edhe sikur të supozohet se ato janë grupuar dhe shpërndarë do të ishin fshirë në mënyrë kronologjike sepse fshirja nënkupton së paku një shtypje të tastit në tastierë apo në "maus".

- "Zinxhiri i kujdestarisë" që nga momenti i sekuestrimit deri në prezantimin e provave përpara gjykatës, kundërshtohet në bazë të provave me shkrim të cilat tregojnë se kompjuteri dhe memoria e jashtme i është dorëzuar shërbimeve të tjera, dhe se përpara ekspertizës askush nuk e ka ditur vendndodhjen e kompjuterit, kush e ka marrë atë, kur e kanë kthyer, etj.
- Gjykata ka dështuar për të përcaktuar nëse ka pasur mundësi të manipulimit të një kompjuteri që nuk është inspektuar për ca kohë që nga dita e sekuestrimit.
- Vlera numerike e identifikimit (hash) e hard diskut nuk është marrë në praninë e avokatit mbrojtës ose të të pandehurit.
- Koha e BIOS-it (Basic Input-Output System - Sistemit Bazik Hyrje-Dalës) është ndryshuar nga eksperti për të treguar se ngjarjet kanë ndodhur në një kohë që i përshtatet prokurorisë.
- Pranueshmëria e provave elektronike është e pakuptueshme, për shkak se termat teknologjik janë në gjuhën angleze dhe ato përsëriten në deklaratë (skedar (file), Koshi i riciklimit 'Recycle Bin', etj.)¹³³
- Urdhri i gjykatave që të printohen provat elektronike. Është çështja e sasisë ajo që shkakton probleme, jo vetëm natyra e materialeve që do të printohen¹³⁴.

Nuk janë dhënë informata nëse ndonjë apo të gjitha këto pohime kanë çuar në përjashtimin e provave elektronike si të papranueshme.

Në Serbi ka përvoja të përdorimit të provave elektronike në gjykata. Gjykatat e pranojnë paraqitjen e provave elektronike në formën kompjuterikekompjuterike, kurse raportet e ekspertëve paraqiten me shkrim. Gjykatat kanë pajisje për trajtimin e provave elektronike dhe për shikimin e tyre. Ato po ashtu, kanë përvojë në trajtimin e çështjeve që përfshijnë analizat e ekspertizës ligjore të provave elektronike. Një ndër çështjet kryesore që është evidentuar në Pyetësor, është se gjyqtarët nuk marrin pjesë në trajnime të specializuara në të njëjtën mënyrë sikurse prokurorët, rrjedhimisht për ta është sfidë që t'i kuptojnë metodat për marrjen dhe prezantimin e provave elektronike. Në policinë e Serbisë, konsiderohet se ka shumë pak njerëz që janë të përfshirë në ekspertizën ligjore kompjuterikekompjuterike. Nuk ka përvojë me urdhrat e gjykatave për kufizimin e shtrirjes së kontrollimit të provave elektronike gjatë procesit të ekspertizës ligjore. Në kuadër të sistemit serb, provat i paraqiten gjykatës nga prokurori dhe nuk është e nevojshme që një ekspert të jetë gjithmonë i pranishëm. Një dëshmitar ekspert mund të thirret nga gjykata, prokuroria apo mbrojtja për të qartësuar gjetjet dhe opinionet e tij, apo për të shtuar gjetje dhe opinione të reja.

Nuk është dhënë ndonjë informatë rreth numrit të gjykatave të cilat i kanë strukturat për t'u marrë me provat elektronike, ose efektin në drejtësinë penale nga mungesa e dalluar e njohurive të gjyqtarëve dhe burimet e pakta në kuadër të policisë, për ekspertizën ligjore kompjuterikekompjuterike; për shembull, mos po çon kjo e fundit në vonesa të papranueshme në përpunimin e provave elektronike.¹³⁵

Në lidhje me asetet e ruajtura në formë elektronike, sipas KPP është e mundur që ky informacion të përdoret si dëshmi. Nuk ka ndonjë detyrim për të kthyer qoftë origjinalin apo një kopje të asetëve të ruajtura në formë elektronike. Kur provat e asetëve të mbajtura në formë elektronike zbulohen gjatë ekzaminimit të ekspertizës ligjore, kur ato nuk kanë qenë synimi i kontrollimit, gjetja do të regjistrohet në raportin e ekzaminimit.¹³⁶

¹³³ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetja 29).

¹³⁴ Përgjigjet e pyetësorit – Njësia e Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 31).

¹³⁵ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 30 deri në 36).

¹³⁶ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 37 deri në 39).

Nuk është e qartë nga pyetjet nëse është një praktikë e zakonshme që asetet të kontrollohen elektronike gjatë të gjitha ekzaminimeve të ekspertizës ligjore të provave elektronike, apo nëse gjetja e tyre është më shumë diçka e rastësishme.

Në lidhje me provat e siguruar nga palët e treta, përgjigjet e dhëna ishin të kufizuara në lidhje me provat e siguruar nga ofruesit e shërbimeve. Në këto raste, kërkesa i dërgohet ofruesit në bazë të një urdhri të gjykatës. Sidoqoftë, është sugjeruar se të gjitha provat e palëve të treta t; trajtohen në këtë mënyrë. Është e mundur që të mblidhen dëshmi nga palët e treta me pajtimin e tyre. Në këto raste, nuk ka nevojë për masa detyruese. Sipas ligjit, është e mundur që t'i kërkohej palës së tretë që ta mbajë çështjen konfidenciale. Në rrethanat kur raportohet për raportin e një krimi që përfshin dëshmi, provat elektronike mund të mblidhen duke i kërkuar personit raportues që t'i ofrojë ato në formë elektronike, ose për shembull që policia të vizitojë një ueb faqe të identifikuar dhe t'i shkarkojë vetë provat; kjo e fundit për shembull vlen për shitjen e mallrave të falsifikuara përmes Internetit (emrat e ueb faqes, profilet e Facebook, etj.)¹³⁷

Nga përgjigjet e pyetësorit nuk është e qartë nëse ekzistojnë procedura për të siguruar integritetin e provave të mbledhura në këtë mënyrë, ose nëse ekzistojnë hapa për t'u siguruar se është ruajtur "zinxhiri i kujdestarisë".

Provat e siguruar nga juridiksionet e tjera nuk janë vlerësuar si të papranueshme në procedurat në Serbi. Nuk ka kërkesa speciale kundrejt vendit dërgues, përveç që, në pajtim me Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik, të jetë përmes pikave të kontaktit dhe kërkesave të Asistencës Reciproke Ligjore.¹³⁸

Sipas komenteve të prokurorëve serb, përmirësime nevojiten për procedurën e Asistencës Reciproke Ligjore kur bëhet fjalë për provat elektronike. Nevojitet thjeshtësimi i kësaj procedure, duke pasur parasysh se koha është faktori kyç në marrjen e provave elektronike, dhe potenciali për dëshmi të fshihet ose komprometohet nëse nuk sigurohet brenda një kohe të arsyeshme.

¹³⁷ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 40 deri në 42).

¹³⁸ Përgjigjet e Rishikuara të Serbisë në Pyetësor (pyetjet 43 deri në 44).

2.6. Turqia

Përgjigjet e Pyetësorit janë dhënë nga një hetues i krimit kibernetik, një specialist i ekspertizës ligjore kompjuterike dhe një prokuror.

Në sistemin turk të drejtësisë, Kodi i Procedurës Penale (Ligji Nr.5271) është burimi kryesor i legjislacionit në lidhje me kategoritë e provave. Rregulloret për zbatimin e tij dhe praktikat ligjore të gjykatave i vendosin parimet në lidhje me pajtueshmërinë e kodit me zhvillimet bashkëkohore dhe teknologjike¹³⁹. Është dhënë lista në vijim e kategorive të provave¹⁴⁰:

- Deklaratat
- Dokumentet
- Provat Kompjuterike
- Provat e Gjurmëve.

Kodi i Procedurës Penale tregon se provat elektronike janë të pranueshme në rastet penale. Në veçanti, Neni 134 i Kodit të Procedurës Penale parasheh masa mbrojtëse (për marrjen e provave) gjatë proceseve penale¹⁴¹. Sipas kësaj dispozite, në mënyrë që provat elektronike të jenë të pranueshme, ato duhet të sigurohen përmes metodave dhe procedurave të veçanta. Përndryshe, ato nuk konsiderohen si dëshmi¹⁴². Krahas kësaj, pranueshmëria e provave i nënshtrohet vendimit të gjyqtarit pas kërkesës së parashtruar nga prokurorët publik dhe në veçanti të konfiskimit, është e nevojshme që provat kompjuterike të kodohen ose të jenë konfidenciale¹⁴³.

Provat elektronike janë po ashtu të pranueshme në çështjet civile, në pajtim me Kodin e Procedurës Civile (Ligji Nr.6100)¹⁴⁴. Në rastet e tilla provat mund të jenë në formën e shtypur ose teksteve të publikuara, dokumenteve zyrtare, vizatimeve, planeve, skicave, fotografive, filmave, video apo audio regjistrimeve si dhe dokumenteve të ngjashme të cilat përmbajnë informacione dhe të dhëna elektronike. Për më tepër, në pajtim me Kodin e Procedurës Civile, të dhënat e krijuara në pajtim me procedurën dhe me nënshkrim elektronik konsiderohen si dokumente zyrtare. Gjyqtari do të bëjë një ekzaminim kryesisht nëse dokumenti i nënshkruar në mënyrë elektronike dhe që shërben si dëshmi për gjykatën është krijuar me përdorimin e nënshkrimit të sigurt elektronik. Gjyqtari do të kërkojë një ekzaminim nga eksperti nëse të dhënat e krijuara me një nënshkrim elektronik refuzohen si dëshmi. Gjyqtari do ta marrë këtë vendim vetëm nëse ai/ajo nuk është në gjendje që të krijojë një mendim pasi t'i ketë dëgjuar të dyja palët. Palët janë të detyruara që t'i parashtrorjnë të gjitha dokumentet që ato dhe pala tjetër i konsiderojnë si dëshmi. Dokumentet elektronike do t'i prezantohen gjykatës pasi që të jenë shtypur dhe kur ato të ruhen

¹³⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 1(a)).

¹⁴⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 1(a)).

¹⁴¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 1(b)).

¹⁴² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 1(c)).

¹⁴³ Përgjigjet e pyetësorit të Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 1(a)).

¹⁴⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 1(d)).

në një bazë elektronike të të dhënave në atë mënyre që të jenë në dispozicion të gjykatës për ekzaminim¹⁴⁵.

Janë theksuar disa fusha të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë nevojë për përpunim, dhe ato janë¹⁴⁶:

- Sekuestrimi i të dhënave
- Kontrollimi i materialit dixhital të personave që nuk kanë lidhje me krimin
- Vendimi i prokurorit publik për kontrollinkontrollin dhe sekuestrimin në çështjet urgjente.

Vendim i një gjyqtari, me kërkesën e një prokurori, duhet të:

- Autorizojë kontrollin e kompjuterëve dhe rrjeteve¹⁴⁷
- Autorizojë ekzaminimin e ekspertizës ligjore të kompjuterëve/disqeve¹⁴⁸
- Autorizojë imazhimin e të dhënave¹⁴⁹.

Ndonëse, Kodi i Procedurës Penale nuk e rregullon në mënyrë specifike çështjen e marrjes së drejtpërdrejt të të dhënave, është e mundur që të kryhen marrjet e drejtpërdrejta në kompjuterë të cilët janë sekuestruar në bazë të një urdhri për kontrollim, nëse rrethanat e lejojnë një gjë të tillë. Në rastet e tilla, kërkohet vendimi i një gjyqtari me kërkesën e një prokurori¹⁵⁰.

Neni 134 i Kodit të Procedurës Penale parasheh se të dhënat mund të merren dhe sekuestrimi mund të aplikohet. Sipas kësaj dispozite ligjore, është e mundur që të konfiskohen të dhënat pa i konfiskuar objektet fizike. Në rastet kur nuk është e mundur që të kopjohen të dhënat në vend, do të merret një kopje e tërë sistemit dhe objektet fizike do të kthehen. Nëse nuk është e mundur që të krijohet një kopje në vend, objektet fizike do të sekuestrohen dhe do të kthehen pasi që të jenë marrë kopjet e tyre. Data e kapura në këtë mënyrë duhet të jenë të koduara ose konfidenciale¹⁵¹. Disa shembuj të përqasjeve të përdorura në raste praktike kur nuk ishte e mundur që të sekuestroreshin objektet fizike janë dhënë në përgjigjet e pyetësorit:

- Nëse të dhënat janë në zotërim të një personi ose institucioni të tretë (p.sh, në një sistem 'cloud'), ato kërkohen nga ata.
- Aksesit i drejtpërdrejtë në sistem është ruajtur dhe në këtë mënyrë të dhënat janë siguruar përmes marrjes së imazheve.

Neni 134 i Kodit të Procedurës Kriminale e lejon imazhimin në vend ashtu si edhe marrjen e drejtpërdrejtë të të dhënave¹⁵².

Institucionet e ndryshme kanë udhëzime për policinë për sekuestrimin e provave elektronike¹⁵³. Për shembull, ka udhëzime për parimet dhe instruksionet në lidhje me Informatikën e Ekspertizës

¹⁴⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 1(e)).

¹⁴⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 4).

¹⁴⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 5).

¹⁴⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 6).

¹⁴⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 7).

¹⁵⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 8).

¹⁵¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 9).

¹⁵² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetjet 11 dhe 12).

Ligjore në Zbatimin e Ligjit¹⁵⁴. Provat e sekuestruara nga autoriteti hetimor ruhen në pajtim me procedurat në rregulloren për asetet kriminale. Ruajtja e provave bëhet nga autoriteti hetimor ose nga autoritet gjyqësore (ruajtja gjyqësore). Në pajtim më Kodin e Procedurës Penale, provat kompjuterike do të ruhen deri sa të sigurohet kopja e tyre gjyqësore (*p.sh.* deri sa prokurorit t'i jepet një kopje). Sapo të sigurohet kopja, ato do t'i kthehen pronarit të tyre¹⁵⁵. Parimi kryesor në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të provave elektronike është konfidencialiteti i hetimit¹⁵⁶. Aksesit në materialin e konfiskuar mund të jetë i kufizuar dhe legjislacioni e përcakton se kush, dhe në çfarë procesi mund të ketë akses në materialin e konfiskuar¹⁵⁷.

Në kuadër të kornizës së marrëdhënieve ndërkombëtare, nuk ka pengesa për të kërkuar asistencë nga një shtet tjetër, organizatë ndërkombëtare ose palë private në ekzaminimin e ekspertizës ligjore kompjuterike¹⁵⁸.

Nuk ka kufizime kohore për ekzaminimin e provave elektronike, por duhet të jepen informata për procesin, duke e shpjeguar statusin e ekzaminimit pas një kohe të caktuar. Procedura e ekzaminimit do të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë fazës së hetimeve dhe provat më pas do t'iu transferohen autoriteteve gjyqësore¹⁵⁹.

Provat duhet të magazinohen me shpejt[si nga autoritetet gjyqësore pasi të jenë përfunduar procedurat tek autoritetet për zbatimin e ligjit. Për më tepër, praktika e marrjes së një kopjeje të vulosur të imazhit për pronarin e pajisjes(ve) është futur në Kodin e Procedurës Penale për të parandaluar shtrembërimin e provave. Në rast se ka ndonjë kundërshtim rreth integritetit të provave, kopja e vulosur dorëzohet nga personi nga i cili janë siguruar dhe ekzaminuar provat¹⁶⁰. Ekzaminimi duhet të kryhet në kopjet gjyqësore të provave kompjuterike dhe tërësia/integriteti i provave duhet të kontrollohet vazhdimisht duke i përdorur vlerat identifikuese (hash)¹⁶¹. Integriteti i provave elektronike verifikohet, gjithashtu, duke i kontrolluar regjistrat, nënshkrimet dhe gjendjen fizike të kontejnerit të provave¹⁶².

Në mënyrë që prokuroria të përcaktojë se kontrollimi elektronik është zhvilluar në mënyrë të përshtatshme, është e rëndësishme që të sigurohet se respektohen praktikat e kontrollimit, marrjes dhe pranisë së personit dhe/ose përfaqësuesve të tij gjatë imazhimit dhe e drejta e personit që të kërkojë një prej imazheve të dyfishta të siguruara. Nëse imazhi nuk mund të merret në vend, personi në fjalë ose avokati i tij duhet të ftohet dhe një imazh duhet të bëhet pasi të vulozet imazhi dhe të sillet në zyrën e zbatimit të ligjit¹⁶³. Për të siguruar zhvillimin e duhur të

¹⁵³ Përgjigjet e pyetësorit të Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 13).

¹⁵⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 13).

¹⁵⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 14).

¹⁵⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 15).

¹⁵⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 15).

¹⁵⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 16).

¹⁵⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 17).

¹⁶⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 18).

¹⁶¹ Përgjigjet e pyetësorit të Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 18).

¹⁶² Përgjigjet e pyetësorit të Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 18).

¹⁶³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimin Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 19).

ekzaminimit të ekspertizës ligjore, imazhi i marrë nga autoriteti për zbatimin e ligjit duhet të ruhet dhe më pas të dërgohet për ekzaminim e ekspertizës ligjore pa e hapur vulën e saj¹⁶⁴.

Në mënyrë që provat elektronike të jenë të pranueshme, mund të jetë e nevojshme që autoriteti hetues të vërtetojë se provat e sekuestruara nuk janë ndryshuar nga prokurori. Është e detyrueshme që të vërtetohet se sekuestrimi, konfiskimi dhe ekzaminimi i kryer i këtyre provave janë bërë në pajtim me rregulloret dhe se është ruajtur zinxhiri dhe tërësia e provave. Praktika e marrjes të një kopjeje të imazhit të ekspertizës ligjore për të dyshuarin synon arritjen e këtij qëllimi¹⁶⁵.

I dyshuari ose përfaqësuesi i tij/saj e ka të drejtën që të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit dhe imazhimit (nëse ai kryhet në vend). Në fakt, prania e të dyshuarit apo përfaqësuesit të tij/saj gjatë kontrollimit dhe imazhimit të ekspertizës ligjore është vënë si rregull. Të dyshuarit i ofrohet një kopje e imazhi të ekspertizës ligjore që është kryer gjatë imazhimit. Prandaj ata e kanë një kopje të plotë të të dhënave dhe rrjedhimisht nuk ka dispozita ligjore në lidhje me praninë e të dyshuarit për procedurat që nuk mund të kompletohen në bazë të të dhënave që nuk janë kapur gjatë kohës së ekzaminimit në vend. I dyshuari ose përfaqësuesi i tij/saj nuk janë të pranishëm gjatë analizës së ekspertizës ligjore¹⁶⁶.

Në bazë të Kodit të Procedurës Penale, sapo të jetë bërë kopja e materialit të sekuestruar, ai do t'i dorëzohet pronarit të tij. Autoritetet hetuese dhe të prokurorisë mund të mbajnë vetëm kopjen¹⁶⁷. Nëse është identifikuar se materiali në kompjuter është i paligjshëm, në praktikë këto të dhëna do të nxirren jashtë mjedisit dixhital dhe do të dorëzohet një kërkesë pranë gjykatës për t'i kthyer të dhënat, ndonëse legjislacioni nuk është i qartë në lidhje me këtë çështje¹⁶⁸. Nuk është e lejuar që pas ekzaminimit të kthehet një hard disk në rast të dyshimit për terrorizëm apo një hard disku që përmban imazhe të paligjshme¹⁶⁹.

Përgjigjet e pyetësorit i japin disa shembuj të përvojave të të anketuarve në lidhje me kundërshtimet e mbrojtjes për pranueshmërinë e provave elektronike. Ato janë¹⁷⁰:

- Nëse imazhi i ekspertizës ligjore nuk është bërë në vend, i pandehuri mund ta kundërshtojë për shkak se nuk ka qenë të pranishëm gjatë procesit të imazhimit.
- Se të dhënat nuk janë marrë sipas procedurave të duhura.
- Se të dhënat nuk janë ruajtur sipas procedurave të duhura.
- Se një kopje e të dhënave nuk i është dhënë të dyshuarit.
- Se të dhënat janë ndryshuar pas imazhimit/se integriteti i provave është komprometuar.

Në përgjigjet e pyetësorit është raportuar se gjykatat kanë përvojë në përdorimin e provave elektronike, i kanë pajisjet për t'i shikuar dhe përdorur provat elektronike dhe kanë përvojë me

¹⁶⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 20).

¹⁶⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Kriminologjisë dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 21).

¹⁶⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Kriminologjisë dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetjet 22-26).

¹⁶⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Njësisë së Kriminologjisë dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 27).

¹⁶⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 28).

¹⁶⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 27).

¹⁷⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Kriminologjisë dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 29).

analizat e ekspertizës ligjore elektronike¹⁷¹. Shembujt e problemeve të hasura në prezantimin e provave elektronike janë¹⁷²:

- Gjykatave u pëlqen që t'i kenë raportet e shtypura, por kjo mund të adresohet përmes komunikimit dhe shpjegimit të duhur.
- Pas dorëzimit të raportit të ekzaminimit të të dhënave në dosjen e çështjes, është e detyrueshme që të paraqiten të dhënat mbi të cilat është bazuar raporti me shpjegimet ose mostra të pamjeve të ekranit (foto apo video).

Shembujt të tjerë të problemeve me analizat e ekspertizës ligjore janë cituar në lidhje me gjykatat që lëshojnë urdhra për analizat e ekspertizës ligjore me afate të paarsyeshme të shkurtra për analizim¹⁷³.

Gjatë seminarit rajonal në Bukuresht është raportuar se vëllimi i artefakteve të mbledhura për shkak të situatës politike të kohëve të fundit në Turqi, do të thotë se proceset që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe menaxhimin e provave elektronike nuk janë respektuar në të gjitha rastet. Me sa duket rregulloret ekzistuese kombëtare dhe Procedurat Standarde Operacionale të cilat i vendosin rregullat për marrjen, trajtimin dhe ruajtjen e të dhënave nuk janë respektuar gjithmonë, posaçërisht në lidhje me respektimin e zinxhirit të kujdestarisë, dokumentimin dhe raportimin, prezantimin e informacionit për mbrojtjen, etj. Kjo ngre pyetje në lidhje me autenticitetin e provave elektronike, si dhe e rrezikon parimin e barazisë së mundësive gjë që ka gjasa që të çojë në kundërshtime me kalimin e kohës kur rastet që kanë të bëjnë me këto dëshmi të përfundojnë përpara gjykatave.

Nuk është një kërkesë ligjore që provat elektronike të prezantohen para gjykatës nga një dëshmitar ekspert. Në rastet kur një raport dhe/ose gjetjet nuk kuptohen ose nuk janë të sqaruara qartë, gjykata mund të kërkojë sqarime nga një dëshmitar ekspert. Për më tepër, nëse provat elektronike mblihen nga zyrtarët për zbatimin e ligjit, atëherë, me kërkesë të mbrojtjes, gjykata mund të dëgjojë një dëshmitar ekspert për shpalosjen dhe auditimin e procedurave të përdorura¹⁷⁴.

Kodi i Procedurës Penale lejon që asetet e ruajtura në formë elektronike të përdoren si dëshmi¹⁷⁵. Rrallëherë ndodh që një ekzaminim i provave elektronike do të kërkonte asetet e ruajtura në formën elektronike (p.sh. portofolet e valutës virtuale)¹⁷⁶. Është e detyrueshme me ligj që origjinali dhe kopja t'i dorëzohen të dyshuarit, përveç në rastet kur kthimi i tyre mund të rezultojë me dëmtime. Në rastet e tilla, origjinali dhe kopja nuk do të kthehen¹⁷⁷.

Kodi i Procedurës Penale e lejon marrjen e provave elektronike nga palët e treta dhe në rastet e tilla parimet e përgjithshme për marrjen e provave janë po ashtu të zbatueshme për provat

¹⁷¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimit Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetjet 30, 32, 33).

¹⁷² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 31).

¹⁷³ Përgjigjet e pyetësorit të Njësisë së Krimit Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 33(a)).

¹⁷⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetjet 35 dhe 36).

¹⁷⁵ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimit Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 37).

¹⁷⁶ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 39).

¹⁷⁷ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njësisë së Krimit Kibernetik dhe Njësisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 38).

elektronike¹⁷⁸. Sidoqoftë, kur nuk është e mundur që të sigurohet një vendim për kontrollim/hetim kundër një personi i cili nuk i shkëmben me dëshirë të dhënat elektronike dhe provat në kuadër të kontekstit të hetimit penal, bëhen përpjekje për t'i siguruar provat në kuadër të kontekstit të detyrimit statutor për t'iu bindur një urdhri të gjykatës¹⁷⁹. Është e mundur që të mblidhen dëshmi nga palët e treta me pajtimin e tyre. Sidoqoftë, nëse nuk ka pajtim, është e mundur që të kërkohet sekuestrimi i provave¹⁸⁰ dhe në rastet e tilla është e mundur që ata ta ruajnë konfidencialitetin e kësaj çështjeje¹⁸¹. Në rastet që i përfshijnë raportimet e krimeve të personave individual, do të bëhet një raport dhe do të mblidhen provat relevante (me pajtimin e personit)¹⁸².

Kur provat sigurohen nga një shtet tjetër, integriteti i provave konfirmohet sipas kuadrit të rregullave teknike kombëtare. Për qëllim të pranueshmërisë, mjafton që të konstatohet se të dhënat janë siguruar në pajtim me legjislacionin kombëtar të shtetit të huaj. Është raportuar në përgjigjet e pyetësorit se ka pasur raste kur provat nga një vend tjetër janë shpallur të papranueshme në Turqi¹⁸³.

Disa rekomandime përfundimtare që janë dhënë në përgjigjet e pyetësorit ishin¹⁸⁴:

- Prokurorët duhet të jenë në gjendje që të japin një urdhër për kontrollim për provat elektronike në rast të një emergjence.
- Kur palët e treta, nuk pajtohen me ekzaminimin, ekzaminimi duhet të urdhërohet nga gjyqtari.
- Një kontrollim në lidhje me sistemet 'cloud' duhet të bazohet në ligj.
- Shtimi i shpejtësisë së marrjes së provave kompjuterike.
- Centralizimi i ruajtjes së kopjeve të ekspertizës ligjore.
- Përdorimi i kutive specifike për transportimin dhe ruajtjen e provave kompjuterike.
- Bashkëpunimi mes laboratorëve të ekspertizës ligjore kompjuterike.
- Trajnimet për personelin jo teknik.
- Shtimi i numrit të praktikuesve të ekspertizës ligjore kompjuterike.

¹⁷⁸ Përgjigjet e pyetësorit të Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetjet 40 dhe 40(a)).

¹⁷⁹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit (pyetja 40).

¹⁸⁰ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetja 40(b)).

¹⁸¹ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 41).

¹⁸² Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 42).

¹⁸³ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit, Njesisë së Krimit Kibernetik dhe Njesisë së Ekspertizës Ligjore Kompjuterike (pyetjet 43 dhe 44).

¹⁸⁴ Përgjigjet e pyetësorit të Zyrës së Prokurorit dhe Departamentit Kompjuterik të Ekspertizës Ligjore të Këshillit të Mjekësisë Ligjore (pyetja 45).

2.7. Kosova*

Përgjigjet e Pyetësorit janë dhënë nga një hetues i krimit kibernetik, një ekspert i ekspertizës ligjore kompjuterike, një hetues financiar dhe një gjykatës.

Provat elektronike nuk përmenden shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Sidoqoftë, Neni 105 i KPP shprehimisht i përmend pajisjet elektronike, duke përfshirë kompjuterët, telefonat celularë, dhe pajisjet elektronike të lëvizshme, duke nënkuptuar kështu se provat elektronike janë një formë e provave të pranueshme¹⁸⁵. Kuptohet se provat elektronike u nënshtrohen rregullave të njëjta të pranueshmërisë si çdo lloj tjetër i provave.¹⁸⁶

Një gjyqtar e autorizon kontrollin e kompjuterëve ose rrjeteve, dhe një gjyqtar ose prokuror mund të autorizojnë ekzaminimet e ekspertizës ligjore të kompjuterëve, imazhimit të të dhënave, dhe marrjen e drejtpërdrejt. Rregullat në lidhje me kontrollin e të dhënave janë të përcaktuara me ligj, dhe në raste të veçanta gjykata mund të kufizojë kontrollin në skedarë, emra, periudha specifike etj. Hetuesit janë të detyruar që të sekuestrojnë objektet fizike për t'i siguruar të dhënat; përndryshe nuk ka asnjë dispozitë për sekuestrimin e të dhënave¹⁸⁷. Është e mundur që të dhënat të imazhohen në vend dhe që të zhvillohet sigurimi i drejtpërdrejt i të dhënave në vend. Ekspertiza ligjore e drejtpërdrejtë është përdorur kur nuk ka pasur ndonjë objekt fizik për ta sekuestruar¹⁸⁸. Është e mundur që çështja të mbetet konfidenciale¹⁸⁹. Hetuesit i respektojnë Procedurat Standarde të Operimit të Policisë së Kosovës* për sekuestrimin e provave elektronike dhe këshillat e ekspertëve, duke përfshirë Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Provat Elektronike¹⁹⁰. Hetuesit do të kontrollojnë asetet e ruajtura në formë elektronike nëse kjo kërkohet me urdhër¹⁹¹.

Sekuestrimi, ruajtja dhe mbajtja e provave elektronike qeverisen nga dispozitat e Neneve 105 (Kontrollimi dhe Sekuestrimi i Përkohshëm), 112 (Sekuestrimi i Përkohshëm) dhe 115 (Konfiskimi i Përhershëm i Artikujve të Sekuestruar Përkohësisht) të KPP¹⁹².

Neni 105 parasheh se "6. Urdhër kontrolli lëshohet me shkrim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë".

Neni 112 parasheh se "9. Sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit mund t'ia delegojë mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht nga paragrafët 5., 6. dhe 8. të këtij Neni".

Neni 115 parasheh se "4. Sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontejnerët përkatës apo në qeset transparente të plastikës dhe zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send apo grup të shkresave" [...] "9. Sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit mund t'ia delegojë

¹⁸⁵Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 1a.

¹⁸⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 1b.

¹⁸⁷ Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 34 dhe 5-8; Neni 18 (Sekuestrimi, Kopjimi dhe Ruajtja e të Dhënave) të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Krimit Kibernetik.

¹⁸⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 10-12.

¹⁸⁹Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 15.

¹⁹⁰Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 13 dhe 18; prezantimi i delegatëve të Kosovës* gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

¹⁹¹Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 39.

¹⁹² Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 14 dhe 18.

mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht nga paragrafët 5, 6 dhe 8 të këtij Neni”.

Sipas Nenit 18¹⁹³ (Sekuestrimi, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave) të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik, kopjet e të dhënave të sekuestruara do të krijohen përmes procedurave teknike të cilat e sigurojnë integritetin dhe sigurinë e të dhënave. Nëse organi për hetimin e krimit ose gjykata konsideron se konfiskimi i objekteve që përmbajnë të dhëna ndikojnë shumë në personat që i posedojnë këto objekte, mund të krijohet një kopje e saktë e të dhënave dhe të përdoret në vend të tyre, duke i lënë të dhënat origjinale tek zotëruesi.

Hetuesi i ekspertizës ligjore kompjuterike ka komentuar se kërkesat e prokurorëve dhe gjyqtarëve për ekzaminime të ekspertizës ligjore duhet të jenë sa më specifike që të jetë e mundur. Për me tepër, rregullat e qarta me shkrim nevojiten për të specifikuar mënyrën dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së regjistrave pas përfundimit të ekzaminimit dhe për ekzaminimin e të dhënave në sistemet 'cloud'¹⁹⁴.

Nuk ka kufizime për ekzaminimin dhe provat e sekuestruara mund të mbahen pafundësisht nga qeveria¹⁹⁵.

Pranueshmëria e provave qeveriset nga KPP, duke përfshirë Nenin 111(1), i cili i përmend bazat e detajuara mbi të cilat mund të refuzohen provat nëse:

- “1.1. provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës, janë të papranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retroaktiv gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës;
- 1.2. kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit kompetent në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;
- 1.3. urdhri i gjyqtarit kompetent është lëshuar në kundërshtim me procedurën e parashikuar me këtë Kod;
- 1.4. përmbajtja e urdhrin të gjyqtarit kompetent është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Kod;
- 1.5. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit kompetent;
- 1.6. personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit; ose
- 1.7. kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 108 të këtij Kodi.

¹⁹³ Neni 18 (Sekuestrimi, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave) i Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik: 1. Për qëllimet e nenit 17 nën-paragrafi 1.2. prokurori propozon për sekuestrimin e objekteve, pajisjeve që përmbajnë të dhëna kompjuterike, të dhëna mbi trafikun e të dhënave, të dhëna mbi shfrytëzuesin, nga personi ose ofruesi i shërbimeve që i zotëron ato, me qëllim të krijimit të kopjeve që mund të shërbejnë si dëshmi.

2. Nëse objektet, pajisjet që përmbajnë të dhëna i referohen të dhënave për organet e drejtësisë në mënyrë që të krijojnë kopje, sipas paragrafit 1 të këtij neni, urdhri i gjykatës për konfiskimin e detyruar i komunikohet prokurorit, i cili ndërmerr masa për ta përmbushur atë.

3. Kopjet sipas paragrafit 1 të këtij neni krijohen përmes mjeteve teknike programeve kompjuterike dhe procedurave që sigurojnë integritetin dhe sigurinë e informatave.

4. Prokurori në çdo kohë mund të urdhërojë kontrollimin me qëllim të zbulimit ose mbledhjes së provave të nevojshme për kontrollim të sistemit kompjuterik ose pajisjes kompjuterike për ruajtjen e të dhënave.

5. Nëse organi për hetimin e krimit ose gjykata konsideron se konfiskimi i objekteve që përmbajnë të dhëna të cilat i referohen paragrafit 1 ndikojnë shumë në aktivitetet e kryera nga personat që posedojnë këto objekte, urdhëron krijimin e kopjeve që do shërbenin si dëshmi dhe të cilat janë krijuar sipas paragrafit 3 të këtij neni.

6. Kur në rastin e hetimit të sistemit kompjuterik apo pajisjes së kompjuterit për ruajtjen e të dhënave mësohet se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë të përfshira në një tjetër sistem kompjuterik ose në ndonjë pajisje tjetër kompjuterike për ruajtjen e dhënave dhe që aksesimi në to nga ofrohet sistemi fillestar apo pajisjet, mund të urdhërohet kryerja e kontrollit në mënyrë që të hulumtohen të gjitha sistemet kompjuterike ose pajisja kompjuterike për ruajtjen e të dhënave të kërkuara.

¹⁹⁴Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 45c.

¹⁹⁵Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 17.

Kur prokuroria ofron dëshmi elektronike, ajo mund të përdorë vlerat identifikuese (hash), vulat kohore, etj., për të vërtetuar pranueshmërinë e tyre¹⁹⁶. Në raste të caktuara, varësisht nga provat e ofruara elektronike dhe nevojës për të demonstruar provat, kërkohet edhe prania e ekspertit¹⁹⁷. Të drejtat e të pandehurit mbrohen në disa mënyra. Nenet 137 dhe 147 të KPP parashohin që, para se të angazhohet një ekspert, Prokurori i Shtetit duhet të lëshojë një vendim i cili e identifikon një ekspert dhe e deklaron ekspertizën e tij/saj, specifikon detyrën e saktë të ekspertit, dhe urdhëron aksesin në dëshmi të ekspertit. I pandehuri ose një përfaqësues nganjëherë mund të jenë të pranishëm gjatë kontrollit, varësisht nga rrethanat e çështjes¹⁹⁸.

Nëse përdoret një ekspert, Neni 138 i KPP parasheh që raporti i ekspertit t'i paraqitet mbrojtjes jo më pak se pesë ditë përpara provës në seancën paraprake dhe jo më shumë se dhjetë ditë pasi e ka marrë prokuroria¹⁹⁹. Për më tepër, Neni 141 i KPP parasheh që mbrojtja mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të paraqesë kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen e tij. Nëse prokurori i shtetit refuzon, i pandehuri mund ta apelojë këtë vendim tek gjyqtari. Krahas kësaj, i pandehuri mund të marrë dhe të paguajë vetë për ekspertizën. Mbrojtja është përgjegjëse për shpenzimet e këtij ekzaminimi dhe duhet të sigurojë një kopje të çdo raporti brenda katërmëdhjetë (14) ditëve pas përfundimit të raportit²⁰⁰. Në qoftë se të dhënat në konstatimin e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht, ose kur ekzistojnë mangësi të tjera (të specifikuara) të materialeve, mund të kërkohen mendimet e ekspertëve të tjerë²⁰¹. Një Prokuror i Shtetit, po ashtu, mund të autorizojë një zyrtar të policisë që të inspektojë, analizojë dhe kontrollojë për dëshmi në media dhe pajisjet elektronike²⁰². Nëse është e nevojshme mund të përdoren ekspertët e jashtëm.²⁰³

Në përgjithësi, Neni 115 (Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht) i KPP e parasheh kthimin e pajisjeve dhe të dhënave tek pronari (duke përfshirë të pandehurin) në fund të çështjes. Sendet nuk do të kthehen në bazë të disa rrethanave të caktuara, duke përfshirë kur ato të jenë dëshmuar në gjykatë se e kanë mundësuar veprën penale ose janë përfitim material nga vepra penale ose nëse vet të dhënat janë të paligjshme - për shembull pamje të eksploatimit të fëmijëve.²⁰⁴ Neni 115 parasheh se:

1. Sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht sipas nenit 112 të këtij Kodi në fund të procedurës penale i kthehen pronarit apo zotëruesit sipas nenit 116 të këtij Kodi, përveç nëse veprimet janë marrë sipas paragrafit 2. të këtij neni apo nëse ndonjë veprim tjetër i lejuar me ligj do të ofronte bazën për të mos kthyer sendet, pasurinë, provat apo paratë.

2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron sekuestrimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit:

2.1. përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përhershëm,

2.2. nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;

¹⁹⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 21.

¹⁹⁷Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 36.

¹⁹⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 23. Mbrojtja nuk do të jetë e pranishme gjatë imazhimit apo ekzaminimit të ekspertizës ligjore (pyetjet 24 dhe 25).

¹⁹⁹Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 26.

²⁰⁰ Neni 141 i KPP (Ekspertët e Angazhuar nga i Pandehuri), pyetjet 22 dhe 29.

²⁰¹ Neni 142 i KPP, pyetja 29.

²⁰²Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 20.

²⁰³ Prezantimi i delegatëve të Kosovës* gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

²⁰⁴ Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 27 dhe 28.

2.3. ligji lejon konfiskimin e tyre.

3. Sendet, pasuria apo provat për të cilat është bërë sekuestrimi i përhershëm shiten dhe të ardhurat nga këto shitje përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit.

Është e mundur që të mblidhen dëshmi nga palët e treta, duke i përfshirë ato ndërkombëtare. Sidoqoftë, të dhënat e siguruara ndërkombëtarisht janë të pranueshme vetëm kur sigurohen përmes Asistencës Reciproke Ligjore²⁰⁵. Është e mundur që të mbahet konfidencial fakti se të dhënat janë siguruar nga palë të treta kombëtare apo ndërkombëtare. Në këto raste zbatohen rregullat standarde të higjienës kompjuterike²⁰⁶. Sidoqoftë, hetuesi policor i krimeve kibernetike ka theksuar se sigurimi i të dhënave nga shtetet e tjera është sfidues dhe kërkon kohë të gjatë për të pranuar përgjigjet e duhura.

Ka vështirësi praktike në Kosovë* me përdorimin e provave elektronike në gjykatë. Aty përfshihen mungesa e pajisjeve dhe programet me versione të vjetruara. Në disa gjykata, vetëm një dhomë mund të ketë pajisje, megjithëse pajisjet janë të vjetruara. Po ashtu, gjyqtarët mund të mos i njohin kompjuterët dhe rrjetet si dhe aspektet më teknike të provave elektronike si steganografia, kriptovalutat, vlerat identifikuese (hash), etj.²⁰⁷. Gjyqtari në delegacion sugjeroi se hetuesit fokusohen më shumë në përdorimin e provave elektronike, pasi ato janë gjithnjë e më shumë relevante në çdo rast, dhe që pajisjet e nevojshme të ofrohen në të gjitha gjykatat²⁰⁸.

Gjatë diskutimeve në seminarin rajonal në Bukuresht, delegatët i theksuan një sërë sfidash:

- Identifikimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi kibernetik, duke i përfshirë ato nga Darknet dhe kriptovalutat, si dhe përcaktimi i pronësisë;
- Nevojitet ndërtimi i kapaciteteve në mënyrë që zyrtarët të mund të ecin me hapin e trendeve teknologjik dhe të trajtohen, duke përfshirë trajnimet e përbashkëta;
- Bashkëpunimi kombëtar në lidhje me vlerësimet e kërcënimit dhe bashkëpunimi publik/privat;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për të tejkaluar pengesat ligjore për të siguruar provat elektronike, duke e përfshirë përdorimin e hetimeve të përbashkëta;
- Nevoja për të rishikuar KPP dhe për të përcaktuar shprehimisht provat elektronike;
- Nevoja për t'i shkruar procedurat për trajtimin e provave elektronike jo në KPP por në procedurat standarde të operimit;
- Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të specifikojnë në urdhrat e tyre përkatës të dhënat që duhet të sekuestrohen dhe të mos urdhërojnë sekuestrimin e të gjitha të dhënave, përderisa do të mjaftonte një kontroll më i ngushtë; dhe
- Nevojiten përmirësime të burimeve - për shembull, më shumë hapësirë për ruajtje, përditësim të programeve dhe të kompjuterëve. Në veçanti, nevojiten më shumë ekspertë për ekzaminime.

²⁰⁵ Prezantimi i delegatëve të Kosovës* gjatë seminarit rajonal në Bukuresht.

²⁰⁶Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 15 dhe 40-43.

²⁰⁷Përgjigjet e pyetësorit, pyetjet 30-33.

²⁰⁸Përgjigjet e pyetësorit, pyetja 45d.

3. Rekomandimet

Rekomandim: Kodet e Procedurave Penale duhet të përfshijnë një përkufizim për provat elektronike dhe/ose përfshirjen e provave elektronike në listën e llojeve të provave.

Për ato juridiksione që nuk i kanë përmendur provat kompjuterike ose elektronike në Kodet e tyre të Procedurave Penale, rekomandohet që ato të përfshihen. Disa prej juridiksioneve i interpretojnë "dokumentet" ose "sendet e lëvizshme" si lloj i provave që i përfshijnë edhe provat elektronike, por ky interpretim mund të hasë në vështirësi në rrethana praktike për kontrollin dhe sekuestrimin e provave elektronike. Një shembull i mirë i kësaj pyetjeje të ekspertizës ligjore të drejtpërdrejtë të të dhënave dhe nëse të dhënat janë mbledhur përmes ekspertizës ligjore të drejtpërdrejtë mund të mblidhen me një urdhër kontrolli, apo nëse kërkohet një urdhër për marrjen apo analizimin e tyre (varësisht nga veçoritë e juridiksioneve të ndryshme).

Rekomandim: Zhvillimi i standardeve të shkruara për kontrollin, sekuestrimin, ruajtjen dhe analizimin e provave elektronike.

Për ato juridiksione që nuk kanë standarde të shkruara (p.sh. Procedura Standarde të Operimit) për kontrollin, sekuestrimin, ruajtjen dhe analizimin e provave elektronike, rekomandohet që t'i zhvillojnë ato. Kishte një konsensus në mesin e pjesëmarrësve në seminarin rajonal të mbajtur në Bukuresht (2-3 nëntor 2017) se do të ishte gabim që të përfshihen detajet operacionale përshkruese në Kodin e Procedurës Penale, sepse Procedurat Standarde të Operimit ose format e tjera të dokumenteve operacionale mund të përditësohen më shpejt në përgjigje të kërkesave të ndryshueshme teknike. Mund të jetë e arsyeshme të merren në konsideratë rregulloret si alternativë ndaj ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale për të njëjtat arsye që u dhanë për përdorimin e Procedurave Standarde të Operimit.

Edhe procedurat për zhvillimin e operacioneve të fshehta online mund të mbulohen nga Procedurat Standarde të Operimit, nëse këtë gjë e lejon legjislacioni kombëtar. Disa shtete e përmendën këtë çështje.

Krahas kësaj, shtetet mund të dëshirojnë që të adresojnë në Procedurat e tyre Standarde Operacionale sekuestrimin dhe kthimin e sistemeve dhe të dhënave tek palët e treta. Shtetet duken se kishin rregulla relativisht të qarta në Kodet e tyre të Procedurave Penale për kthimin e tyre tek të pandehurit, por asnjëri shtet nuk i ka përmendur të drejtat e palëve të treta - për shembull, bizneset e pafajshme aktiviteti i të cilave mund të ndërpritet për shkak të sekuestrimeve që kanë të bëjnë me një punonjës.

Rekomandim: Të merret në konsideratë kërkimi i aseteve virtuale në procedurat e kontrollimit, përzgjedhjes dhe analizës preliminare të provave elektronike.

Disa juridiksione e parashohin, pas përfundimit të marrjes së një imazhi të ekspertizës ligjore, kthimin e provave origjinale, një kopjeje, apo të dyjave tek të dyshuarit. Ekziston një përjashtim ndaj kësaj kërkesë kur veprimi tillë do të shkaktoje dëmtime (p.sh. kompjuterin që përmban imazhe të paligjshme). Kjo e krijon një problem ku hetuesit, për shkak të kërkesës ligjore për ta kthyer një kopje të provave, mund t'i ofrojnë një të dyshuari mundësinë që t'i lëvizë asetet virtuale jashtë shtrirjes së procedurave të ardhshme të sekuestrimit/humbjes. Asetet e tilla mund të kenë vlerë të konsiderueshme. Ky rrezik nuk do të identifikohet përveç nëse kontrollimi/përzgjedhja e provave elektronike, në kohën e marrjes së tyre, nuk e parasheh edhe kontrollin për asetet virtuale (p.sh. portofolet e valutave virtuale).

Prandaj, rekomandohet që procedurat për kontrollin/marrjen/përzgjedhjen e provave elektronike të krijohen/ndryshohen për të përfshirë kërkimin për asetet virtuale, deri në atë shkallë që kjo është e mundur teknikisht.

Rekomandim: Duhet të zhvillohen/përmirësohen trajnime kombëtare për gjyqtarët/prokurorët për të adresuar sfidat me urdhrat për kontrollin/analizimin e provave elektronike.

Disa prej juridiksioneve kanë treguar se ekzistojnë sfida me urdhrat për kontrollin/analizimin e provave elektronike që kërkohen nga prokurorët dhe që lëshohen nga gjykatat. Këto sfida ndahen në dy kategori të gjera. Së pari, urdhrat që urdhërojnë kontrollin e një kompjuteri për "të gjitha provat" ose diçka të ngjashme. Së dyti, urdhrat që kanë afate tejet të shkurtra kohore. Këto sfida kërkojnë ngritjen e vetëdijes rreth veçorive të provave elektronike në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Prandaj rekomandohet që të zhvillohen/përmirësohen trajnimet për t'ua mundësuar gjyqtarëve dhe prokurorëve që të marrin në konsideratë këto çështje dhe që të kenë vetëdije për sfidat që përfshihen në analizimin e provave elektronike.

Rekomandim: Të merret në konsideratë vendosja e procedurave efektive për të trajtuar vëllime të mëdha të çështjeve dhe mbingarkesat e pakontrollueshme të provave elektronike.

Është raportuar për një vëllim tejet të madh të çështjeve dhe mbingarkesa të pakontrollueshme, procedurat për trajtimin e provave elektronike mund të mos respektohen saktësisht në të gjitha rastet. Kjo mund të krijojë sfida për pranueshmërinë e këtyre provave në procedurat gjyqësore dhe në shkelje të procesit të rregullt. Në rastet e tilla, shtetet mund të marrin në konsideratë vendosjen e një modeli tërësisht të dokumentuar dhe përparësisë sipas vlerësimit të rrezikut / klasifikimit si bazë për një hierarki me shkallë të analizës së ekspertizës ligjore. Në një model të tillë, reaguesve të parë (ose analistëve të ekspertizës ligjore me aftësi relativisht të ulëta) mund t'u sigurohen mjete të automatizuara për filtrimin e të gjitha provave elektronike të konfiskuara, duke i kaluar vetëm artefaktet më të rëndësishme për analizim të mëtejshëm nga analistët e ekspertizës ligjore me shkathtësi të larta. Çdo mjet që përdoret për këtë qëllim duhet të testohet në tërësi dhe të verifikohet para përdorimit. Përdoruesit e këtyre mjeteve duhet të kenë trajnimet e duhura për përdorimin e tyre dhe të kenë autorizimet ligjore për t'i përdorur. Trajnimi duhet të përfshijë të kuptuarit e rëndësisë e sendeve që do të sekuestrohen dhe caktimin e prioriteteve për të shmangur sekuestrimin e sendeve të panevojshme. Parimi i mbajtjes së regjistrave duhet të ruhet gjatë tërë procesit. Kështu, analistët e kualifikuar të ekspertizës ligjore mund të kalojnë një pjesë më të madhe të kohës së tyre duke punuar në sendet më të rëndësishme, në vend se të kenë nevojë që të kalojnë një pjesë të mirë të kohës duke imazhuar dhe më pas duke i mënjeluar provat e panevojshme. Gjithashtu, mund të merret në konsideratë baza ligjore dhe procedurale për zhvillimin e kësaj forme të përzgjedhjes. Çdo përdorim i metodave të tilla, zakonisht do të ketë nevojë të shpaloset në tërësi gjatë procedurave pasuese ligjore.

Rekomandim: formalizimi i procedurave për trajtimin e provave elektronike përmes ligjeve, rregulloreve apo proceseve të tjera formale.

Një shtet ka raportuar se ka procedura të konsoliduara mirë, por të pa dokumentuara, për trajtimin e provave elektronike, të cilat janë pranuar nga gjykatat për vite të tëra. Sidoqoftë, ka raste kur ato nuk respektohen, për shkak të mungesës së përvojës dhe mungesës së njohurive të procedurave nga ana e prokurorëve, të cilët e kanë përgjegjësinë e përgjithshme për procesin hetues. Aksesit i drejtpërdrejt në provat origjinale, me raste urdhërohet nga prokurorët, në kundërshtim me procedurat dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për trajtimin e provave elektronike, pasuar nga ekzaminuesit e ekspertizës ligjore kompjuterike. Kjo mund të ketë ndikim serioz në integritetin e çdo dëshmie të gjetur dhe pranueshmërinë e saj dhe mund të çojë në shkelje të procesit të duhur. Rekomandohet që në të ardhmen, kurdo që të haset një dukuri e

tillë, prokurorëve t'iu shpjegohen procedurat dhe që të krijohet një regjistër i shkruar i çdo ndryshimi të urdhëruar.

Për të adresuar shkakun thelbësor të kësaj çështjeje, rekomandohet që autoritetet të marrin në konsideratë miratimin e procedurave kombëtare përmes ligjeve, rregulloreve dhe proceseve të tjera formale, të cilat do të përcaktojnë procedurat e rregullta që do të ndiqen në të gjitha rastet ku do të mblidhen dhe inspektohen dëshmi elektronike gjatë një hetimi.

Rekomandim: Të zhvillohen trajnime për reaguesit e parë, të cilat do t'iu mundësojnë që ta trajtojnë më mirë mbledhjen e sasive të mëdha të provave elektronike nga burimet në kuadër të autoritetit nën të cilin veprojnë.

Të përcaktohen protokolle me shkrim dhe të trajnohen reaguesit e parë si duhet në mënyrë që kontrollimet të kufizohen në minimumin e nevojshëm. Kjo do t'i pakësojë rastet e mbledhjes së provave të panevojshme të cilat nuk mund të analizohen sipas standardeve të mira të ekspertizës ligjore apo nuk mund të analizohen fare.

4. Shtojcat

4.1. Pyetësi i Zbrazët

| Nr. | Ligji në Lidhje me provat | (Nëse "Po" në cilëndo pyetje, ju lutemi që t'i ofroni detajet/formulimet e ligjit) |
|-----|--|--|
| 1 | | |
| | a. A parashohin ligjet e shtetit tuaj se provat elektronike janë të pranueshme në rastet penale? | Po/Jo |
| | b. A ka kërkesa specifike në çështjet penale për pranueshmërinë e provave elektronike? | Po/Jo |
| | c. A e parashohin ligjet e shtetit tuaj pranueshmërinë e provave elektronike në çështjet civile? | Po/Jo |
| | d. A ka kërkesa specifike në çështjet civile për pranueshmërinë e provave elektronike? | Po/Jo |
| 2 | Nëse vendi juaj nuk ka ligj të shkruar, mbi çfarë baze ligjore vendosen rastet e provave elektronike në çështjet penale? | |
| 3 | Nëse vendi juaj nuk ka ligj të shkruar, mbi çfarë baze ligjore vendosen çështjet e provave elektronike në rastet civile? | |
| 4 | A krijon ligji, apo mungesa e tij, probleme specifike në rastet që i përfshijnë provat elektronike? Nëse po, ju lutemi që të ofroni një skicë të çështjeve të përfshira. | |
| | Sekuestrimi i të Dhënave Elektronike | |
| 5 | Cili person apo autoritet e autorizon kontrollin e kompjuterëve ose rrjeteve? | |
| 6 | Cili person apo autoritet i autorizon ekzaminimet e ekspertizës ligjore të kompjuterëve/disqeve? | |
| 7 | Cili person apo autoritet e autorizon imazhimin e të dhënave? | |
| 8 | Cili person apo autoritet e autorizon marrjen e drejtpërdrejtë? | |
| 9 | Në çështjet penale apo civile, ju kërkohet që të sekuestroni objekte fizike, si kompjuterët/disqet? Apo, a mund të sekuestroni të dhënat pa i sekuestruar objektet fizike? | |
| 10 | Nëse e keni trajtuar një rast ku nuk ka pasur një objekt fizik për ta sekuestruar, ju lutemi që të shpjegoni se çfarë keni bërë për t'i sekuestruar të dhënat. | |
| 11 | A është e mundur që të imazhohen të dhënat në vend? | |

| | | |
|----|--|--|
| 12 | A është mundur që të zhvillohet marrja e drejtpërdrejtë e të dhënave në vend? | |
| 13 | A keni udhëzime kombëtare për sekuestrimin e provave elektronike? | |
| 14 | Si ruhen provat elektronike pasi janë sekuestruar? Kush i ruan ato? Sa kohë mund të mbahen nga prokuroria? | |
| 15 | Është e mundur që kërkohet ruajtja e konfidencialitetit të sekuestrimit? A ka kufizime ndaj konfidencialitetit? | |
| 16 | A mundet vendi juaj që t'i kërkojë një shteti tjetër, organizate ndërkombëtare ose pale private asistencë për ekzaminimin e ekspertizës ligjore kompjuterike? | |
| 17 | A ka ndonjë kufizim kohor për ekzaminimin e provave elektronike? | |
| | Ndjekja Penale dhe të Drejtat e të Pandehurit | |
| 18 | Çka duhet të bëjë prokuroria për të përcaktuar se provat elektronike janë ruajtur në mënyrë e duhur dhe nuk janë ndryshuar (zinxhiri i kujdestarisë)? | |
| 19 | Çka duhet të bëjë prokuroria për të përcaktuar se kontrollimi elektronik është zhvilluar në mënyrën e duhur? | |
| 20 | Çka duhet të bëjë prokuroria për të përcaktuar se ekzaminimi i ekspertizës ligjore është zhvilluar në mënyrën e duhur? | |
| 21 | Çka duhet të vërtetojë prokuroria në mënyrë që të dhënat elektronike të jenë të pranueshme si dëshmi? Për shembull, prokurorisë mund t'i kërkohet që të vërtetojë se të dhënat nuk janë ndryshuar nga prokuroria pas sekuestrimit. | |
| 22 | A mundet të inspektojë mbrojtja provat elektronike të prokurorisë? A inspektohet origjinali apo kopja? | |
| 23 | A mundet i pandehuri ose një përfaqësues i tij që të jenë të pranishëm gjatë kontrollimit elektronik? | |
| 24 | A mundet i pandehuri apo përfaqësuesi i tij të jetë i pranishëm gjatë imazhimit të të dhënave? | |
| 25 | A mundet i pandehuri apo përfaqësuesi i tij të jetë i pranishëm gjatë analizës së ekspertizës ligjore? | |
| 26 | A ka të drejtë mbrojtja që të marrë një kopje të provave elektronike për të përgatitur çështjen e saj? | |
| 27 | A i kërkohet prokurorisë që t'ia kthejë pajisjet apo të dhënat pronarit, duke përfshirë edhe të pandehurin? Nëse po, a mundet prokuroria që të kthejë një kopje të të dhënave, dhe jo origjinalin? | |

| | | |
|-----------|---|--|
| 28 | A ndryshojnë përgjigjet e tri pyetjeve paraprake nëse zotërimi i materialit të ruajtur në kompjuter është i paligjshëm (p.sh. pamje të abuzimit seksual të fëmijëve)? | |
| 29 | Të pandehurit mund të kundërshtojnë provat elektronike të prokurorisë. Ju lutemi shënoni çdo kundërshtim të mbrojtjes për të cilin duhet të diskutojë grupi. | |
| | Të Dhënat Elektronike dhe Gjykatat | |
| 30 | A ka vendi juaj përvojë në përdorimin e provave elektronike në gjykata? | |
| 31 | Nëse keni njohuri rreth problemeve me përdorimin e provave elektronike, ju lutemi që të shënoni cilindo për të cilin duhet të diskutojë grupi. Për shembull, gjykatat mund të urdhërojnë printimin e provave elektronike dhe dorëzimin e tyre në letër. | |
| 32 | A i kanë gjykatat pajisjet për të shikuar dhe përdorur provat elektronike? | |
| 33 | A kanë përvojë gjykatat me analizat e ekspertizës ligjore elektronike? | |
| | a. Nëse po, ju lutemi që të shënoni cilindo për të cilin duhet të diskutojë grupi. Për shembull, një gjykatë mund të caktojë një afat për analizim që është tejet i shkurtër që të mundësojë një ekzaminim të duhur. | |
| 34 | A vendosin gjykatat rregulla për prokurorinë në lidhje me mënyrën si mund të kontrollohen të dhënat? Për shembull, një gjykatë mund të urdhërojë prokurorinë që të kontrollojë vetëm për fjalë të caktuara, ose të kontrollojë vetëm në zona të caktuara të një disku të sekuestruar. | |
| 35 | A është kërkesë ligjore në vendin tuaj që të prezantohen provat elektronike nga një "dëshmitar ekspert"? | |
| 36 | Nëse nuk ka kërkesa ligjore që provat elektronike të prezantohen nga një dëshmitar ekspert, në çfarë rrethanash duhet të ftohet një dëshmitar për të prezantuar apo konfirmuar autenticitetin e provave elektronike? | |
| | Asetet e Ruajtura në Formë Elektronike | |
| 37 | A është e mundur të përdoren si dëshmi asetet e ruajtura në formën elektronike? Nëse po, mbi çfarë baze ligjore? | |
| 38 | Nëse identifikohen asete të ruajtura në formë elektronike, a është e detyruar prokuroria që t'ia kthejë të pandehurit origjinalin apo kopjen e provave elektronike? | |

| | | |
|-----------|---|--|
| 39 | A është rutinë/e pritur që një ekzaminim i provave elektronike të kontrollojë asetet e ruajtura në formë elektronike (p.sh. portofolet e valutave virtuale)? | |
| | Sigurimi i Provave Elektronike nga Palët e Treta (personat, kompanitë, dhe organizatat që nuk janë as shënjestra e as të pandehur) | |
| 40 | A është e mundur që të sigurohen dëshmi elektronike nga palët e treta? Nëse po, mbi çfarë baze ligjore? | |
| | b. Nëse po, a sigurohen në të njëjtën mënyrë të gjitha provat elektronike që mbahen nga palët e treta? | |
| | a. Sipas ligjit dhe praktikave të vendit tuaj, a është e mundur që të sigurohen të dhëna nga palët e treta përmes bashkëpunimit, apo janë të gjitha procedurat detyruese? Për shembull, nëse një palë e tretë është e gatshme që të japë të dhëna nga sistemi i saj, a mund të bashkëpunoni ju në kontrollin e sistemit, apo ju duhet që të zbatoni vetëm sekuestrimin? | |
| 41 | Nëse të dhënat sigurohen nga palët e treta, ose me asistencën e tyre, a mund t'iu kërkohet që të ruajnë konfidencialitetin në këtë çështje? | |
| 42 | Nëse një person privat e raporton një vepër penale në të cilën përfshihen provat elektronike, cilat procedura duhet të ndjekin autoritetet për zbatimin e ligjit për të ruajtur apo marrë të dhënat e personit? | |
| | Çështjet Ndërkombëtare | |
| 43 | Nëse provat elektronike sigurohen nga një shtet tjetër, a ka rregulla speciale për të vërtetuar autenticitetin e provave? | |
| 44 | A ka pasur raste kur provat e tilla janë shpallur të papranueshme nga gjykatat në vendin tuaj? Nëse po, ju lutem jepni detaje. | |
| | Pyetje Shtesë | |
| 45 | Është e rëndësishme që të sigurohen pikëpamjet e pjesëmarrësve të ndryshëm mbi përdorimin e provave elektronike në sistemin e drejtësisë penale. A janë bërë përparime në përdorimin e provave elektronike në çështjet penale dhe civile, dhe nëse po, cilat janë ato përmirësime? Nëse është e mundur, ju lutemi që të kërkonit komente si për aspektet ligjore ashtu edhe për ato praktike nga kategoritë e pjesëmarrësve në vijim. | |
| | a) Komentet e prokurorëve | |

| | | |
|--|---|--|
| | b) Komentet nga Hetuesit Penalë të Policisë (Këtu mund të përfshihen hetuesit e krimeve kibernetike, financiare dhe të krimeve tradicionale të cilët hasin në dëshmi elektronike.) | |
| | c) Komentet nga Hetuesit e Ekspertizës Ligjore Kompjuterike të Policisë | |
| | d) Komentet nga Gjyqtarët | |
| | e) Komentet nga Avokatët Mbrojtës | |
| | f) Komente të tjera | |